

## Fushata Ashpërsohen qëndrimet për Referendumin

Fq.3



## RASTI TANK Gruevski vazhdon të ankohet

Fq.5



## GRIZMAN

Meritoj  
të jem në  
Top 3 për  
Topin e Artë

Fq.22



# Koha

www.koha.mk

## Mianmari si Gjermania naziste

Fq.16



E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3453 · e enjte, 6 shtator 2018

15°C | 27°C

15 DEN

### FORUM

#### Luli i vocërr i shekullit të ri



Askush se njihje Lulin e vocërr të Migjenit, dhe askush mbase se njih djalin i cili ditën e parë të shkollës e filloi në vend se me çantë të re, si gjithë moshatarët e tij, me një qese plasmasi, të cilën e kishe hedhur pas shpine. Krahët i kishte shtirë tek vendi ku zakonisht qesja mbahet me dorë dhe ecte kokë ulur. Nga dhjetëra e dhjetëra foto të fillimit të vitit shkollor mua kjo më tërhoqi vëmendjen dhe një tjetër për të cilën do flas pak më poshtë. Pamje sa një mijë fjalë. 1. A jetojmë në shoqëri kaq të ndara mes klasash...

Fq.11

### GLOBI

#### Më shumë kontroll ndaj Google!

Fq.15

### RAJON

#### Parisi kundër ndryshimit të kufijve, rikujton parimet e Badinterit

Fq.14



## ANKOHEN BUJQIT DHE PROFESORËT E BUJQËSISË

# SUBVENCIONET NË DUAR TË GABUARA



Në Lidhjen e Sindikatës të Bujqve thonë se, edhe pse gati 12 vite shteti jep subvencione, në vend që të kemi rritje të hapësirave tokësore të mbjella me kultura bujqësore, ndodhë e kundërta - kemi zvogëlim të këtyre hapësirave, rritje të importit të prodhimeve bujqësore nga shtetet e rajonit, si dhe keqpërdorime të mëdha me shpërndarjen e subvencioneve

Fq.4

## Të tërhiqen librat skandalozë të muzikës

Shkup, 5 shtator - Librat e orës së muzikës për shkollat e ciklit fillor dhe të mesëm, tërësisht të pavlefshme, vazhdojnë të shpërndahen edhe këtë vit shkollor. Të indinjuar nga situata absurde e krijuar për arsimtarët dhe nxënësit për më shumë se 10 vjet, Lidhja e Pedagogëve të Muzikës Shqiptare (LPMSHM) kërkon nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të gjejë zgjidhje për të penguar jo vetëm shpërndarjen e tyre,

por edhe të problemit duke mundësuar botimin e librave të reja, me autorë shqiptarë dhe jo të përkthyer dhe të përshtatura nga gjuha maqedonase. Adem Ymeri, kryetar i LPMSHM, thotë se kërkesa e tyre është kategorike dhe insiston në ndryshimin dhe plotësimin Ligjit aktual, sipas të cilit librat duhet të përkthehen nga maqedonishtja, si edhe të shpallet konkurs për tekstet e reja shkollore...

Fq.4



## EDITORIAL

DITIRAMB PËR PUNËT  
E PREMTUARA  
DHE KURRË TË  
MBARUARA!

Emin AZEMI

A ka të ngjarë që zhvillimi ekonomik e social në nivelin komunal të paguaj tagrin e "politikave të mëdha" që i kanë udhëhequr tash e disa vite deputetët e ministrat e garniturave të ndryshme qeverisëse? Shumë projekte të premtuara e të pafilluara kurrë, shumë të nisura e të pambaruara asnjëherë, janë pasojë e mosdefinimit të qartë të strategjive qeveritare për të rikthyer resurset e zhvillimit ekonomik e social në nivel komunal. Mungesa e një etike të mirëfilltë politike që kishte prodhuar premtime pa mbulesë, ka demotivuar në përmasa shqetësuese çdo individ që do të kishte dëshirë të investojë në vendlindjen e tij. Premtimet zakonisht bëheshin në prag të zgjedhjeve, kurse politikanët e papërgjegjshëm vazhdonin ta "kullotnin" mandatin me projekte (fiktive) madhore për qumështore, thertore, tjeritore e baritore. Politikanët të tillë edhe sot ndeshim nëpër tribuna parareferendumiane, duke tundur në ajër projekte mashtruese që si sedativ gjumëndjellës injektojnë lojalitete të zorit e të hallit.

Asnjë parti politike në këto dekada nuk ndëshkoi politikanët mashtrues në radhët e veta. Përkundrazi, madje pati edhe shpërblime për ndonjërin që pastaj ishte detyruar të vijë tinëz, në orët e mbrëmjes, në fshatin e tij si pasojë e mospërbushjes së premtimeve spektakolare. Është habi e madhe si apratçikët të tillë të pasuksesshëm iu bëjnë përshtypje liderëve partiak të cilët vazhdojnë të mahniten me mospunën e ndonjërit prej tyre. Të padëshuarit e fshatrave e lagjeve tona, ende vazhdojnë të qëndrojnë si ushujza nëpër listat kadrovike të liderëve tanë. Këta të fundit nuk po arrijnë të lirohen nga hipnozot që vijën prej individëve të cilët ende 'kriter zotësie' kanë refuzimin e ndonjë intelektualit a profesionistit, sepse vetëm në mesin e intelektualëve e profesionistëve apratçikët tanë pa tru ndjehen keq.

A mundet të ndodhë që të bëhet ndonjë projekt i hairit që për autorë të ketë ndonjë aparatçikë pa tru? Ata që besojnë se kjo mund të ndodhë, vazhdojnë të na bindin se partia e tyre megjithatë po del fituese në zgjedhje, por harrojnë se këto janë fitore që nuk çojnë kurrfarë peshe në konkurrencën e mirëfilltë të ideve që sjellin progres ekonomik, kulturor e arsimor. Një parti mund ti fitojë zgjedhjet 100 vjet me radhë dhe kjo të mos reflektohet fare në dimensionin lokal të jetës së njerëzve, sepse banorët sërish vazhdojnë të marrin para nga të afërmit e tyre në kurbet për të mbajtur gjallë ekzistencën familjare. Një parti që fiton zgjedhjet, mund të jetë diçka pozitive për jetën e disa funksionarëve bashkë me familjet e tyre, dhe kjo nëse nuk përkthehet në impakt të përgjithshëm kolektiv, atëherë i bie që ajo fitore ka një funksion tepër të reduktuar që (pa)zotësinë profesionale e kthen në lojalitet të gërditshëm ndaj partisë që siguron vetëm mirëqenie individuale por jo edhe kolektive. Fatbardhësisht ka edhe përjashtime. Ka edhe funksionarë që fitoren politike nuk e konsideron privilegj, por obligim për të bërë më shumë për bazën prej nga vjen. Ka edhe funksionarë të dinjitetshëm që përveç pagës mujore nuk e fut dorën edhe në thesin e pistë të tenderëve e dallaveve.

A mund të ndodhë që funksionarët e tillë të mos propozohen edhe për një mandat? Për këtë pyesni aparatçikët pa tru, të cilët bëjnë lobime të forta që funksionarët e dinjitetshëm të largohen nga listat kadrovike dhe në vend të tyre të mbesin ata vet, sepse vetëm jokonkurrenca i nxjerr ata të pa lagur në brigjet e punëve të premtuara dhe kurrë të mbaruara. A thua liderët tanë cilën anë do të mbajnë?

## REFERENDUMI DHE BISHTI I XHEPIT

"Referendumi, fjale, e cila u sjell errësirë dhe mjegull shqiptarëve. Të gjithë ne që jemi kalbur dhe vvarë burgjeve dhe luftërave në territoret e Ishit, duke votuar pro referendumit, duhet të heqim dorë nga idealet tona kombëtare, dhe ti bëjmë zero rezultatet e Referendumit të Iliridës. Heqim dore nga legaliteti dhe legjitimiteti i jonë historik mbi trojet tona. Sovranitetin ia përcjellim një subjekti të ri, maqedonasve të Maqedonisë së Veriut. Me Referendumin do të përforcojmë karakterin unitarist në një realitet binacional të vendit. Do të humbim të drejtën që brenda dhjetë vjetëve të ardhshëm të mos kemi të drejtë të organizojmë Referendum për interesa tona (në botën e civilizuar edhe një fshat vendos për ardhmërinë e vet). Pala tjetër duhet të kishte menduar për këtë ditë, pasi shqiptarët nuk janë gogla xhepi. Mos harroni se pronat e Çameve iu dhanë në pronësi grekeve pasi Greqia u bë anëtare e NATO-s dh BE-së (ku është këtu shenjtëria e pronës). Në Kushtetutën greke janë fshirë të gjithë popujt jogrek. Ne jemi pro NATO dhe BE më shumë se të gjithë sllavët e Ballkanit bashkë, por jo si bisht nëpër xhepat e të tjerëve", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti Shpëtim Pollozhani.

## TEZA E NDRYSHIMIT TË KUFIJVE

"Teza e ndryshimit të kufijve midis Kosovës dhe Serbisë është një tezë e gabuar për disa arsye. Së pari, sepse bie në kundërshtim me parimin themelor politik, diplomatik dhe juridik ndërkombëtar, të vendosur në konferencat ndërkombëtare për ish Jugosllavinë në Hagë dhe në Londër në vitin 1991, që krijimi i shteteve të reja, të dala nga federata jugosllave, do të bëhej mbi bazën e kufijve administrativë, që kishin pasur në kontekstin e federatës. Kosova nuk mund ta prishë këtë rregull ndërkombëtar dhe të krijojë një precedent të rrezikshëm me refuzimin e këtij parimi. Teza e ndryshimit të kufijve është në kundërshtim me marrëveshjen e Kumanovës të 9 qershorit 1999, në të cilën Serbia u detyrua të pranonte largimin e të gjithë forcave të saj ushtarake dhe policore nga i gjithë territori i Kosovës, duke dalë jashtë kufijve, që Kosova i kishte pasur si njësi konstituive e federatës jugosllave. Teza e ndryshimit të kufijve bie në kundërshtim me aktin e madh historik të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, i cili sanksionoi sovranitetin dhe integritetin territorial në gjithë territorin e Kosovës, të çliruar më 12 qershor 1999, dhe që përputhej me kufijtë e Kosovës si njësi konstituive e federatës. Teza e ndryshimit të kufijve bie në kundërshtim me vendimin historik të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila e legalizoi aktin e shpalljes së pavarësisë si të përputhshëm me ligjin ndërkombëtar dhe me rezolutën 1244 të KS të OKB. Teza e ndryshimit të kufijve bie në kundërshtim me Kartën e Helsinkit dhe të Parisit të OSBE-së, të cilat e sanksionuan mosndryshimin e kufijve të shteteve europiane si një nga shtyllat kryesore të rendit të sigurisë evropiane", shkruan në profilin e tij në FB, diplomati nga Tirana Shaban Murati.

## MURI KINEZ

Muri është rreth 21.196 kilometra i gjatë, që nga kufiri me Korenë e Veriut deri në shkretëtirën Gobi. Është shpallur Trashëgimi Botërore nga UNESCO në vitin 1987 dhe që nga viti 2007 është një nga shtatë mrekullitë e Botës. Ndërtimi filloi në shekullin e 8-të dhe zyrtarisht përfundoi në vitin 1644. Në gjendje të mirë është vetëm 8% të strukturës së përgjithshme, që korrespondon me muret e ndërtuara gjatë Dinastisë Ming (1368-1644), pjesa më e dukshme dhe turistike që të gjithë njohim nga kartolinat dhe fotot. Përtej erozionit nga kalimi i kohës dhe shirave, dëmi më i madh është shkaktuar nga vetë kinezët, të cilët kanë çmontuar seksione të mëdha për ti shitur si tulla. Në vitet '70 Muri

shihej si simbol i despotizmit të dinastive të lashta kineze. Qeveria komuniste inkurajonte njerëzit që të përdornin tulla e seksioneve shkatërruara të murit për të ndërtuar shtëpitë e tyre. Ka pasur interes që të restaurohen vetëm zonat më të vizituara dhe ekziston frika se shumë zona së shpejti t'i dorëzohen erozionit. Në pjesët më të vizituara ka të shënuara disa grafite. Shkrimet janë në gjuhë të ndryshme duke e bërë murin mrekullinë arkitektonike më të keqtrajtuar nga turizmi. Qeveria kineze vendosi në vitin 2014 një zonë në seksionin Mutianyu ku vizitorët mund të linin shkrimet e tyre. Shumica e këtyre shkrimeve janë në anglisht, jo në gjuhën kineze.

## MEDIACitate

NUK DO TË  
BISEDOJMË  
KURRË PËR  
GAZIVODËN  
E AS PËR  
MITROVICËN

Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi ka thënë se ai nuk do të bisedojë me Serbinë për Liqenin e Gazivodës (Ujmani) e as për pjesën veriore të Mitrovicës, në kohën ku ai po ballafaqohet me kritika të mëdha nga opozita dhe shoqëria civile se ai po bën pazare me territorin e vendit. Duke folur në një debat në Prishtinë, presidenti Thaçi ka vazhduar të mbështesë idenë e proklamuar që marrëveshja paqësore me Serbinë të përfshijë edhe ndryshimin e kufirit, ose siç e quan ai, "korrigjim të kufirit". Ai ka deklaruar se marrëveshja nuk do të përfshijë ndarje dhe as shkëputje të pjesës veriore të Kosovës. "Çfarë do të thotë kjo? E para nuk do të ketë ndarje të Kosovës. Nuk do të ketë shkëputje të pjesës veriore të Kosovës. E kam thënë më parë dhe e them përsëri, nuk do të bisedojmë kurrë, në asnjë rrethanë për liqenin e Gazivodës (Ujmanit) apo për qytetin e Mitrovicës", tha Thaçi. Në debatin e organizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) presidenti Thaçi ka ritheksuar se arritja e marrëveshje për normalizim e raporteve me Serbinë do t'i hapte Kosovës rrugën e integritetit në Bashkimin Evropian dhe NATO, si dhe anëtarësimin në Kombet e Bashkuara (OKB). "Si Kosovë kemi ndërtuar marrëdhënie të shkëlqyera me Malin e Zi, Maqedoninë dhe Shqipërinë si vende fqinje na mbetet të ndërtojmë marrëdhënie të mira fqinjësore me Serbinë, prandaj jemi angazhuar në dialog me Serbinë tani e sa vite. Është koha tani për marrëveshje të madhe historike përfundimtare mes dy shteteve", u shpreh Thaçi. (REL, 5 shtator)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

FUSHATA ÇDO DITË E MË DINAMIKE

# ASHPËRSOHEM QËNDRIMET PËR REFERENDUMIN

Nga Instituti për demokraci se thonë skenari më i mirë për uljen e tensioneve në shoqëri si dhe mes pozitës dhe opozitës është që Referendumi të dalë i suksesshëm. Ndërkaq VMRO ka përsëritur akuzat se ndryshimi i emrit të Maqedonisë, ndryshimi i Kushtetutës, traditës dhe kulturës është tragjedi dhe jo kompromis i fëmijëve në kopshte



Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 5 shtator - VMRO opozitare dhe LSDM në pushtet së fundmi kanë ashpërsuar qëndrimet pro dhe kundër marrëveshjes për emrin me Greqinë, në prag të Referendimit konsultativ që do të mbahet pikërisht në sajë të kësaj marrëveshje. VMRO-DPMNE, përmes një kumtese për media thekson se ndryshimi i emrit të Maqedonisë, ndryshimi i Kushtetutës, traditës dhe kulturës është tragjedi dhe jo kompromis i fëmijëve në kopshte. Nga kjo parti shtojnë se mohimi i identitetit maqedonas është turp për çdo qytetar që ndjehet maqedonas.

"Zoran Zaev edhe një herë ka prezantuar jo seriozitetin e tij ndaj marrëveshjes së dëmshme me Greqinë. Sjellje të tillë për një temë kaq serioze, nuk ka pasur asnjë politikan në shtet. Qytetarët janë të vetëdijshëm se atë që e bën Zaevi tani, nuk e ka bërë askush", thonë nga VMRO-DPMNE. Ato në fund shtojnë se qytetarët e Maqedonisë kanë ndërgjegje politike dhe pjekuri dhe nuk mbështetin marrëveshje të dëmshme. Nga LSDM menjëherë kanë reaguar kundër këtij qëndrimi të VMRO-së. "Ka ardhur koha që VMRO-DPMNE-ja ta tejkalojë vetveten dhe në vend se të përhapë të pavërtetën të përfshihet në proceset "për" anëtarësimin të Maqedonisë në BE dhe NATO me identitet të përforcuar dhe të mbrojtur maqedonas. E ardhmja e Maqedonisë dhe qytetarëve të saj është mbi të

gjitha partitë politike shqiptare. Inkuadrimi në BE dhe në NATO me identitet të mbrojtur maqedonas është çështje shumë më e madhe nga polemikat politike ditore, porositin nga partia në pushtet LSDM. "Nuk është e saktë se me arritjen e marrëveshjes me Greqinë rrezikohen identiteti dhe veçoria e Maqedonisë. Nuk është e saktë edhe se fshihen nocionet e Maqedonisë dhe maqedonasve. Në të kundërtën, me Marrëveshjen termat maqedonas, maqedonase, të Maqedonisë përgjithmonë janë të mbrojtura dhe askush më nuk do të mundet t'i mohojë ose diskutojë", thonë nga LSDM. Siç thonë ata, sipas nenit 7 nga Marrëveshja, identiteti maqedonas i përshkruan territorin, gjuhën, popullin, me të gjitha atributet, me historinë, kulturën dhe trashëgiminë e saj. "Kjo është e vërteta. Në emër të së vërtetës dhe në emër të së ardhmes, nevojitet të gjitha subjektet politike duke përfshirë edhe VMRO-DPMNE-në të përfshihen në procesin që e siguron të ardhmen e Maqedonisë, t'i bëjnë thirrje anëtarëve të tyre në mënyrë masive të dalin në referendumin 'për' inkuadrimit në BE dhe NATO", shtojnë nga LSDM.

Nga Instituti për Demokraci thonë skenari më i mirë për uljen e tensioneve mes pozitës dhe opozitës edhe në shoqëri është që referendumi të del i suksesshëm. "Kjo është mënyra e vetme dhe deputetët që kanë kontestuar marrëveshjen të pranojnë të votojnë edhe ndryshimet kushtetuese, ku edhe

disa herë është cekur se nëse vullneti i shumicës shprehet haptas në referendum, atëherë do të duhej të votohen edhe ndryshimet kushtetuese", thotë sipas Marko Troshnovski nga kjo organizatë. Nga Qendra amerikane për analiza strategjike Starfor në një artikull të publikuar ditë më parë vlersojnë se referendumi mund ti ashpërsos ndjenjat nacionaliste, si dhe opozitat në të dyja vendet. Qendra amerikane shkruan se edhe nëse referendumi kalon, protestat do të mund të vazhdojnë, sepse që të mund të zbatohet ndryshimi i emrit, Kuvendi domosdo duhet ta ndryshon Kushtetutën që sipas Starfor është proces që ofron edhe një katalizator për protesta masovike antiqeveritare.

Nga ana tjetër, analisti politik Alajdin Demiri nuk pret se do të ketë problem gjatë ndryshimeve kushtetuese në rast se referendumi del i suksesshëm duke u thirrur në spekulimet se edhe deputet të VMRO-DPMNE-së do të votonin për të. "Nëse nuk ka sukses referendumi, Zaev i cili në politikë hyri me atë sintagmë për BE dhe NATO, absolutisht duhet të shkon zgjedhje, në ndërkohë do të fillon presioni nga VMRO-DPMNE që të kthehen në pushtet dhe do të ketë zgjedhje të parakohshme bashkë me ato presidenciale", thotë Demiri. Sipas Demirit, edhe nëse referendumi del i suksesshëm mund të presin zgjedhje të parakohshme, pasi që atëherë Zaev do të dëshironte që ta rris shumicën.

AHMETI TAKOI ZYRTARIN GJERMAN, KRISTIAN HELLBACH

## Gjermania, bashkautore e suksesit euroatlantik

Shkup, 5 shtator - Mbatja e Referendimit, zbatimi i ndryshimeve kushtetuese, reformat dhe zhvillimet rajonale, kanë qenë temë e takimit të kryetarit të Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti me përfaqësuesin Special të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Gjermanisë për Evropën Juglindore, Turqinë dhe Shtetet e EFTA-s, Kristian Hellbah dhe Ambasadorin Gjerman në Maqedoni, Tomas Gerberich. Ahmeti, siç citohet në njoftimi zyrtar, e falënderoi Hellbah për mbështetjen e madhe gjermane për suksesin e marrëveshjes së Prespës dhe integritetit euroatlantik të Maqedonisë. Sipas Ahmetit, shtabi i Bashkimit Demokratik për Integrim për referendumin e 30 shtatorit është në funksion të tërësishëm të suksesit dhe për çdo ditë po strukturohet në terren. Ah-



meti theksoi që shumica dërmuese e qytetarëve nga të gjitha komunitetet në vend e mbështetnin integrimin e vendit në NATO dhe BE, prandaj dhe pret referendum të suksesshëm. Lideri i BDI-së përsëri ftoi opozitën maqedonase dhe atë shqiptare që t'i bashkangjiten rrugës euroatlantike dhe të përkrahin pa mëdyshje përpjekjet për reali-

zim të hapave të domosdoshëm, referendimit dhe ndryshimeve kushtetuese. Ahmeti e përshëndeti vizitën e Kancelares gjermane Angela Merkel të shtunën dhe nënvizoi që sukcesi i integritetit dhe demokratizimit të shoqërisë është sukses i përbashkët i forcave vendore dhe komunitetit ndërkombëtar.

NIMIC PËR PORTALIN PRIZMA

## Zhagitja e marrëveshjes për emrin, ide shumë e rrezikshme



Shkup, 5 shtator - Kaluan 25 vite, ndërsa mund të kalojnë edhe po aq para një marrëveshje të re në qoftë se kjo nuk kalon, thotë ndërmjetësuesi i KB-së në kontestin për emrin Methju Nimic në intervistë për BIRN lidhur me kontestimin e marrëveshjes së arritur midis Maqedonisë dhe Greqisë. Për të, ideja për pritje afatgjate dhe moszbatim të marrëveshjes është shumë e rrezikshme.

"Atyre në shtetin tuaj që thonë 'eja të presim, të lëmë edhe disa vite, do të kemi marrëveshje më të mirë në të ardhmen', unë ju them 'Nuk e dini atëherë se ku do të jetë BE-ja, se nëse do të duan edhe një anëtar, se nëse do të duan që ai të jetë shteti juaj, nuk e dini se ku do të jetë NATO, nuk e dini se çka do të ndodhë në Greqi me ndërrimin e pushtetit, nuk e dini se çka do të ndodhë në rajon. Ideja për pritje afatgjate është shumë e rrezikshme", thekson Nimic. Ai thotë se është optimist i rezervuar, por që megjithatë, nuk ka përfunduar gjithçka. Që marrëveshja të jetë e realizueshme, duhet të kalojë referendumi, të miratohen ndryshimet kushtetuese dhe pastaj parlamenti grek ta ratifikojë. "Shpresoj se do të kalojë në të dy shtetet, sepse është zgjidhje korrekte dhe e ndershme për të dyja palët, por nëse nuk kalon, nuk shoh zgjidhje së shpejti. Kaluan 25 vite, mund të kalojnë edhe 25. Edhe shumë persona do ta humbin interesin, nëse nuk kalon tani në shtetin tuaj", paralajmëron Nimic në intervistë për BIRN që e transmeton PRIZMA.

## Nisin me punë 760 administrativë të MO-së, mbeten edhe 700

Shkup, 5 shtator - Rreth 760 nëpunës të administratës nënshkruan pajtueshmëri për shpërndarjen e tyre në vende pune sipas Marrëveshjes së Ohrit, ndërsa për 160 procedura është përfunduar plotësisht, njoftoi sot zëdhënësi qeveritar Muhamed Hoxha. Në pres konferencën në Qeveri, Hoxha informoi se për 600 persona procedura për shpërndarjen e tyre nëpër institucione sipas Marrëveshjes së Ohrit është në vijim. "Një pjesë nga personat e tjerë, rreth 200, të cilët nuk e kanë pranuar ofertën do tu jepet mundësia që të përfshihen në këtë transfer të parë, nëpër institucione ku ende ka nevojë. Të tjerë do të përfshihen me sistematizimin vijues", sqaroi Hoxha. Sipas tij edhe 700 nëpunës administrate mbeten të shpërndarë nëpër institucione.

ANKOHEN BUJQIT DHE PROFESORËT E BUJQËSISË

# SUBVENCIONET NË DUAR TË GABUARA

Në Lidhjen e Sindikatës të Bujqve thonë se, edhe pse gati 12 vite shteti jep subvencione, në vend që të kemi rritje të hapësirave tokësore të mbjella me kultura bujqësore, ndodhë e kundërta - kemi zvogëlim të këtyre hapësirave, rritje të importit të prodhimeve bujqësore nga shtetet e rajonit, si dhe keqpërdorime të mëdha me shpërndarjen e subvencioneve

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 5 shtator - Subvencionet bujqësore që u ndan nga Qeveria e mëparshme dhe tani nga Qeveria aktuale nuk po japin rezultatet e pritura për bujqit. Profesorë të Fakultetit të Bujqësisë në Shkup thonë se në vazhdimësi, jo vetëm që kemi zvogëlim të hapësirave të tokave bujqësore, por shteti edhe më tej mbetet i varur nga importi i të gjitha prodhimeve bujqësore. Sipas prodhuesve bujqësorë dhe profesorëve universitar të Bujqësisë, arsyet kryesore që në tregjet e gjelbra në Maqedoni kemi sasi të vogla të prodhimeve bujqësore, të cilat shiten me çmime të larta, është për shkak të shpenzimeve të mëdha që kanë bujqit, hapësirat shumë të vogla të tokave, makineri e vjetruar, si dhe mungesa e sistemit për ujitje të tokave bujqësore.

"Problem në vete paraqet edhe mbjellja e shumë kulturave bujqësore, për të cilat bujku individual aspak nuk e mendon plasmanin e prodhimeve. Pastaj shpenzimet e larta të bujqve për të mbjellë tokat, kemi kualitet të dobët të prodhimeve për shkak të



edukimi jo profesional të bujqve dhe kontrollit të dobët nga ana tregtarëve, të cilat i blejnë këto prodhime bujqësore", thotë Jovan Azhderski, profesor pranë Fakultetit të Bujqësisë në Shkup. Sipas tij, është më se e nevojshme që Ministria e Bujqësisë të organizojë trajnime dhe ti ulë në një tavolinë prodhuesit bujqësorë përballë tregtarëve dhe industrisë përpunuese.

"Kështu, të gjithë së bashku të paktën dy herë në vit të takohen dhe atë një muaj para se të fillohet me mbjelljen e kulturave bujqësore dhe një muaj para se prodhimet të fillojnë të lëshohen në treg dhe të merren vesh për sasinë që do grumbullohen nga tregtarët, si dhe cili do të jetë çmimi i blerjes me shumicë të prodhimeve bujqësore. Pra, saktë të dihet se cili është

çmimi për një kilogram i prodhimeve të klasit ekstra, të klasit të parë apo çmimi industrial. Dhe më e rëndësishmja e gjithë kësaj duhet të jetë respektimi i marrëveshjeve dhe nëse dikush nga tregtarët dhe industria përpunuese shkel marrëveshjen, të përgjigjet penalisht për mos respektim të marrëveshjes", thotë profesor Azhderski. Edhe profesori i Bujqësisë, Vladimir Ilievski shprehet se subvencionet të cilat ndahen gati 11 vite me radhë, aspak nuk po japin efektin e pritur.

"Subvencionet nuk kanë arritur efektet e pritura për shkak se pjesa më e madhe e subvencioneve kanë përfunduar në duar të gabuara. Numri më i madh i bujqve individual, me paratë e subvencioneve blejnë farën e grurit pa pyetur për cilësinë e farës, apo çfarë sorte

është. Pra vetëm e vetëm për të marrë subvencionet. Pastaj farën e blerë e mbjellin në hapësira më të vogla të tokës, ndërsa pjesën tjetër të parave të mbetura nga subvencionet e shpenzojnë për blerje të gjërave tjera që aspak nuk korrespondojnë me qëllimin për të cilin shteti i ka destinuar", thotë profesori Ilievski, i cili vlerëson se subvencionet duhet t'ju ndahen atyre bujqve bazuar në faktin se sa hapësirë tokësore kanë mbjellë dhe jo se sa planifikojnë të mbjellin.

Po ashtu, në Lidhjen e Sindikatës të Bujqve nga rajoni i Strumicës thonë se, edhe pse gati 12 vite shteti jep subvencione, në vend që të kemi rritje të hapësirave tokësore të mbjella me kultura bujqësore, ndodhë e kundërta - kemi zvogëlim të këtyre hapësira-

ve, rritje të importit të prodhimeve bujqësore nga shtetet e rajonit, si dhe keqpërdorime të mëdha me shpërndarjen e subvencioneve. "Pjesa më e madhe e këtyre subvencioneve u janë shpërndarë personave që aspak për veprimtari kryesore nuk e kanë bujqësinë apo aktivistëve partiak. Se me të vërtetë ndodhë kështu, mjafton të jesh prezent kur paguhen subvencionet. Të parët që i marrin subvencionet janë personat, të cilët janë aktivist partiak. Pra, pjesa më e madhe e subvencioneve shkon në duar të gabuar, ndërsa ata të cilët me të vërtetë merren me bujqësi, mbeten të fundit që i marrin subvencionet", thonë nga Lidhja e Sindikatës të Bujqve nga rajoni i Strumicës.

Ndryshe, numri i bujqve që shfrytëzojnë subvencione për momentin është 80.000 dhe ky numër nga viti në vit rritet për 10 mijë persona. Subvencione më të larta paguhen për kultivuesit e duhanit. Pikërisht për këta bujq, për vitin 2018 janë paguar 279 milionë euro. Në anën tjetër, nga viti 2008 kur shteti filloi të ndajë subvencione për bujqit e deri në fund të vitit 2013, importi i prodhimeve bujqësore është rritur për 120.5 milionë euro. Ndërkohë, të dhënat e fundit statistikore tregojnë se në kuartalin e parë të viti 2017, eksporti i prodhimeve bujqësore kap shifrën prej 57.5 milionë euro që është për 13.5 për qind më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016.

LPM SHM ME APEL MASH

## Të tërhiqen librat skandalozë të muzikës

Të indinjuar nga situata absurde e krijuar për arsimtarët dhe nxënësit për më shumë se dhjetë vjet Lidhja e Pedagogëve të muzikës shqiptare (LPM SHM) kërkon nga MASH-i të gjejë zgjidhje për të penguar jo vetëm shpërndarjen e tyre, por edhe të problemit duke mundësuar botimin e librave të reja, me autorë shqiptarë dhe jo të përkthyer dhe të përshtatura nga gjuha maqedonase

Koha


Evis HALILI

Shkup, 5 shtator - Librat e orës së muzikës për shkollat e ciklit fillor dhe të mesëm, tërësisht të pavlefshme, vazhdojnë të shpërndahen edhe këtë vit shkollor. Të indinjuar nga situata absurde e krijuar për arsimtarët dhe nxënësit për më shumë se 10 vjet, Lidhja e Pedagogëve të Muzikës Shqiptare (LPM SHM) kërkon nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të gjejë zgjidhje për të penguar jo vetëm shpërndarjen e tyre, por edhe të problemit duke mundësuar botimin e librave të reja, me autorë shqiptarë dhe jo të përkthyer dhe të përshtatura nga gjuha maqedonase. Adem Ymeri, kryetar i LPM SHM, thotë se

kërkesa e tyre është kategorike dhe insiston në ndryshimin dhe plotësimin Ligjit aktual, sipas të cilit librat duhet të përkthehen nga maqedonishtja, si edhe të shpallet konkurs për tekstet e reja shkollore. "Po shpërndahen librat e muzikës edhe këtë vit shkollor, të cilat janë krejtësisht të pavlefshme, kur dihet se në shkolla fillore dhe të mesme prej vitesh këto libra nuk përdoren. Ne si LPM SHM jemi të indinjuar, pasi nuk e dimë se me të drejtën e kujt sërish shpërndahen tekstet që janë të pavlefshme dhe për të cilat në takimet që kemi pasur me përfaqësues të instancave të ndryshme në MASH na është premtuar se nuk do të shpërndahen dhe se ky problem do të zgjidhet me mundësi-

min e botimit të librave të rinj. Librat as nuk mund të korrigjohen, as të përmirësohen, duhet vetëm që të hartohen të reja nga autorë shqiptarë", thotë Ymeri. LPM SHM konsideron se këto libra janë dëshmi e diskriminimit kulturor drejt fëmijëve shqiptar, pasi që në to jo vetëm që nuk ka fare materiale nga muzika dhe kultura shqiptare, por janë të shoqëruara nga fillimi deri në fund me paradokse të ndryshme, me tekste këngësh të përkthyer tekstualisht dhe vijë melodike që nuk korrespondojnë. Nga MASH nuk kanë ndonjë afat konkret për çështjen e botimeve të reja në gjuhën shqipe apo edhe korrigjimin e përmbajtjeve edhe për libra të lëndëve të tjera, si Gjeografi, Hi-

stori, Edukatë, e të tjera. Disa ditë më parë ky institucion bëri me dije se janë korrigjuar një sërë librash, ndërsa punohet për të vazhduar me libra të tjerë. "Ky është fillimi dhe MASH do të vazhdojë edhe me korrigjimin dhe botimin e librave të tjerë, për të cilët do të ketë kërkesa nga ana e shkollave, shoqatave, prindërve dhe të gjitha palëve të tanguara. Jemi të hapur të diskutojmë për të gjitha temat e hapura në arsim, pa përjashtuar edhe këtë çështje", ka deklaruar ministri Adem Ymeri. Për zgjidhjen e problemit me librat e muzikës LPM SHM i është drejtuar MASH disa vjet më parë dhe sipas një marrëveshje fillimi-



sht janë formuar grupe pune me profesorë të muzikës për korrigjimin e teksteve, por dorëshkrimet e punuara nuk u vunë asnjëherë në përdorim. Pas zvarritjes së problemit, LPM SHM kërkoi që tekstet të shpallen pavlefshme për t'i hapur rrugë botimit të librave të rinj, por edhe përfshirjen e vetë Lidhjes në komisionet e MASH, në mënyrë që të mos përsëriten gabimet dhe të krijohen probleme të njëjta.

GJYKATA E APELIT I LEXOI GJASHTË ANKESAT PËR RASTIN "TANK"

## GRUEVSKI VAZHDON TË ANKOHET



Gruevski, në njëren prej ankesave të parashtruara në Gjykatën e Apelit, thotë se në rastin "Tank" i janë shkelur liritë dhe të drejtat e njeriut, ndërsa ka kërkuar respektimin e vendimeve të Gjykatës së Strasburgut, instancë kjo e cila gjatë qeverisjes së tij, me dhjetëra herë ka dëshmuar se në Maqedoni nuk respektohet liritë themelore të njeriut

Koha

Omer XHAFERI

Shkup, 5 shtator - Shkelja e procedurës penale dhe mos pranimi i dëshmimeve nga Gjykata Penale e Shkupit (GJPSH) në rastin "Tank", ishin disa prej arsyeve në të cilat ish-kryeministri Nikolla Gruevski i mbështet ankesat e tij para Gjykatës së Apelit në Shkup. Pavarësisht faktit se kjo seancë u iniciua me nismën e Gruevskit, i cili paraprakisht nga GJPSH-ja u dënua me dy vite burg, ai të mërkurën nuk u paraqit para Këshilli Penal në Gjykatën e Apelit. Ndryshe, i dënuari me 6 vite e gjysmë burg, Gjoko Popovski, ishte prezent në seancë ku nga afër e dëgjoi leximin e ankesave. Kundërshtimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë para Apelit, në rastin "Tank", përbëhet prej gjashtë ankesave,

pesë prej të cilave i takojnë Gruevskit dhe një Popovskit. Në njëren prej këtyre ankesave, ish-kryeministri Gruevski thekson se gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, i janë cenuar liritë dhe të drejta e njeriut. Duke u thirrur në aktgjykime dhe citate nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gruevski në ankesat e tij potencon se nuk mundet të dënohet vetëm në bazë të "bombave" të prezantuara nga Prokuroria Speciale Publike, pasi sipas tij, materialet nga përgjimet e jashtëligjshme janë siguruar në mënyrë joligjore dhe në këtë formë i janë shkelur të drejtat themelore.

"Materialet e prezantuara nga 'bombat' në seancat për rastin 'Tank', kanë qenë kopje dhe jo prova origjinale. Kësisoj, nuk na është lejuar vërtetimi i autenticitetit të këtyre provave. PSP, në këtë rast ka bërë selektimin e atyre përgjimeve që ju kanë konvencuar. Unë si i akuzuar nuk i kam pranuar këto materiale si dëshmi", thotë Gruevski. Njëkohësisht, ai ka theksuar se edhe ekspertiza e porositur nga PSP e të cilën e ka realizuar kompania "EOS Konsalting", nuk është transparente. Kjo procedurë, sipas palës mbrojtëse, është kryer nga persona të afërt me LSDM-në. Ngjashëm si në lëndët tjera që PSP i përfaqëson para Gjykatës Penale të Shkupit, edhe kësaj radhe para Gjykatës së Apelit, avokatët e Gruevski kërkuar shkarkimin e prokurorës speciale Katica Janeva, me arsyetimin se ajo nuk ka kompetencë ligjore për procedimin e këtyre lëndëve. Megjithatë,

një kërkesë e tillë menjëherë u refuzua, me arsyetimin e Janeva nuk mundet të shkarkohet për shkak se Ligjit për prokurorinë speciale nuk e lejon një gjë të tillë.

Njohësit e zhvillimeve dhe praktikës së punës së Gjykatës së Apelit thonë se kjo gjykatë e ka fjalën e fundit se vallë Gruevski do të shkojë në burg ose vepra penale do të vjetrohët. Në rast se Apeli gjatë periudhës që vijon e vërteton vendimin e GJPSH-së, atëherë dënimi ndaj Gruevski bëhet i plotfuqishëm dhe nuk ekziston mundësia për ankimim para Gjykatës Supreme të Maqedonisë. Megjithatë, të akuzuarit, në këtë rast Gruevski dhe Popovski, mund të thirren në mjete të jashtëzakonshme juridike dhe të kërkojnë anulimin e dënimit. Mirëpo, normat e Ligjit për procedurë penale parashohin fillimisht ekzistimin e ndonjë arsye të forta ligjore siç janë sëmundja e rëndë, vdekja e ndonjë anëtarit të afërt të familjes, ndonjë fatkeqësi natyrore, për kujdesin ndaj fëmijëve apo personave të shtyre në moshë. Ndryshe, ditë më parë Gruevski në një konferencë për shtyp, drejtpërdrejt i akuzoi drejtuesit e Gjykatës së Apelit se janë nën presion të lartë politik për të shpallur atë fajtor. Sipas tij, ky vendim pritet të miratohet para datës 30 shtator kur edhe është paraparë mbajtja e Referendimit. Kryesuesja e Këshillit Penal pranë Gjykatës së Apelit, gjykatësja Cvetanka Periq, i ka kundërshtuar këto akuza dhe shkurtë është përgjigjur se nuk është shënjestër e asnjë presioni.

## Dy viktima në aksidentet e muajit gusht

Tetovë, 5 shtator - Muajin e kaluar në rajonin më të gjerë të Tetovës kanë ndodhur 89 aksidente komunikacioni, ose katër më pak në krahasim me të njëjtën periudhë kohore të vitit të kaluar. Dy nga aksidentet e muajit gusht kanë përfunduar me po aq të vdekur, shtatë persona kanë marrë lëndime të rënda trupore, 66 persona me lëndime të lehta, përdërisa në 29 aksidente është shkaktuar vetëm dëm material, i cili në përgjithësi vlerësohet të jetë mbi 3.100.000 denarë. Numri më i madh i aksidenteve kanë ndodhur në rrugët e Tetovës, gjegjësisht 49 prej tyre në rrugën e "Ilindenit", më pas radhitet bulevardi "Vidoja Smilevski Bato", dhe bu-

levardit "Marshall Tito". Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i këtyre aksidenteve kanë ndodhur në autostradën Gostivar-Tetovë-Shkup, si dhe në rrugët rajonale në drejtim të fshatit Pirok dhe Vollkovijë. Si shkak më i shpeshtë i këtyre aksidenteve, në veçanti i atyre me pasojë më të rënda, sërisht është mospërshtatja e shpejtësisë, gjegjësisht nga vozitja e shpejtë kanë ndodhur 26 aksidente, më pas si pasojë e kryerjes së veprimeve të pahijshme në komunikacion kanë ndodhur 20 aksidente si dhe nga mos dhënia e përparësisë së kalimit 14. Më shumë aksidente kanë ndodhur të enjten, gjithsej 17 prej tyre dhe të mërkurën 16, kryesisht në pe-

riudhën kohore nga ora 12:00 deri në orën 14:00 dhe 16:00. Muajin e kaluar, gjithashtu kanë ndodhur 11 dalje nga rruga, ndërsa dy prej tyre janë shkaktuar si pasojë e daljes së kafshëve në rrugë, në të shumtën e rasteve nga qentë endacak, përdërisa në 10 aksidente pjesëmarrëse kanë qenë automjetet e parkuara. Në gusht të këtij viti, gjithsej janë kontrolluar 4476 automjete pas çka janë zbuluar 1749 kundërvajtje të ndryshme, për shkak të të cilave nga komunikacioni janë përjashtuar 71 automjete dhe 152 vozitës. Kundërvajtjet e zbuluara muajin e kaluar janë sanksionuar me 622 fletëpagesa për gjobë. (U.H)

## KRONIKË

## Paditet shkupjani, tentoi ta vrasë gruan

Padi Penale është parashtruar kundër shkupjanit 54-vjeçar i cili më 2 shtator nëpërmjet një mosmarrëveshje verbale është munduar me thikë ta vrasë bashkëshorten e tij. Ministria e Punëve të Brendshme sot kumtoi se B.A. dyshohet për vepër penale "vrasje në tentativë të kryerjes së dhunës familjare". Ai më 2 shtator rreth orës 20:00 në shtëpinë e tyre, pas mosmarrëveshjes së shkurtër verbale me bashkëshorten e tij P.V.(52) me thikë i ka shkaktuar plagë në pjesën e barkut. Pasi që e lënduara ka pasur shumë gjakderdhje, rreth orës 02:30 ka kërkuar ndihmë nga dhëndri dhe me automjetin e tij e kanë dërguar PV. në Spitalin e përgjithshëm të qytetit "Shën Naum i Ohrit" ku është mbajtur për mjekim të mëtutjeshëm. Nëpunësit policorë pas bisedës me të lënduarën, bashkëshortin e saj B.A e kanë privuar nga liria dhe e kanë mbajtur në stacionin policor.

## Lëndohet rëndë një motoçiklist nga Anglia

Një anglez 26-vjeçar është lënduar rëndë në një aksident që mbrëmë ndodhi në rrugën rajonale Mavrovë-Dibrë. Në këtë aksident janë lënduar edhe dy persona. Sipas MPB-së, në aksident kanë marrë pjesë motoçikleta "Honda" me targa britanike, e drejtuar nga J.J.(26) nga Anglia dhe automjeti "Folksvagen Golf" me targa të Gostivarit, i drejtuar nga E.V.(27) nga f. Trebishte-Mavrovë. Në këtë aksident lëndime të rënda trupore ka marrë motoçiklisti dhe është dërguar në spitalin e Dibrës, por për shkak të seriozitetit të lëndimeve është transferuar në Qendrën urgjente pranë Kompleksit të klinikave "Nëna Tereza-Shkup. Shoferi i Golfit E.V. dhe bashkudhëtari në automjet A.V. kanë marrë lëndime të lehta trupore dhe pas ndihmës së dhënë janë lëshuar në mjekim shtëpiak. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi i SPB-së Tetovë.

## Arrestohen dy bullgaret që vidhnin në Bit Pazar

Padi penale është ngritur kundër dy shtetaseve bullgare të cilat kanë grabitur portofol me rreth 18.000 denarë nga një grua në Bit Pazar. Kundër personave R.G.I. (50) dhe N.N.N. (24) të dyja nga Bullgaria, SPB Shkup deri te prokuroria kompetente publike në Shkup parashtroi padi penale për shkak të ekzistimit të dyshimit bazë se kanë kryer vepër penale "grabitje" të dënueshme sipas nenit 235 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë, me ç'rast kanë fituar interes pronësor kundërligjor prej rreth 18.000 denarë. Siç kumtoi MPB, të denoncuarat e kanë kryer veprën në datën 1 të këtij muaji rreth orës 13:30 në rr. "192" në tregun Bit Pazar. Ata e kanë shfrytëzuar turmën dhe pakujdesinë e të dëmtuarës. N.N.N. janë shtyrë drejt saj që t'ia tërheqin vëmendjen, ndërsa R.G.I. e hapi zinxhirin e valixhes dhe e mori portofolin në të cilin ka pasur 240 euro, 2400 denarë dhe dokumente personale. Një person i cili ka qenë në treg, e ka vërejtur ngjarjen dhe ka denoncuar në stacionin policor. Pas kësaj, pas masave të ndërmarra, më 3 shtator rreth orës 13:00 të denoncuarat janë arrestuar dhe janë mbajtur në Stacionin policor në Bit Pazar.

## Shtetasi i Shqipërisë humb jetën duke prerë dru

Të martën rreth orës 10 e 30 minuta, në pyllin që ndodhet në atarin e fshatit Lazaropole, në vendin e quajtur "Jama", duke prerë dru ahu - mbi kokën e shtetasit nga Shqipëria K.C 53-vjeçar ka rënë një degë e cila i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore me ç'rast ka humbur vetëdijen. Menjëherë me veturë të parkut kombëtar "Mavrovë" është dërguar në Spitalin e Dibrës, ndërsa më pas në Spitalin e Ohrit "Shën Erazmi", ku mbrëmë pas mesnate - ka ndërruar jetë. Shtetasi i Shqipërisë përndryshe është angazhuar përmes një firme private nga Struga, e cila ka tenderin për prerjen dhe transportin e drunjve për ngrohje. Prokurori publik dhe ekipi i Sektorit për Punë të Brendshme kanë kryer hetime dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit.



## Tevdovski thotë se nuk ka nevojë për rebalanc

Shkup, 5 shtator - Treguesit makroekonomikë janë të shkëlqyeshëm dhe pozitivë, ndërkaq edhe likuiditeti i buxhetit është i shkëlqyeshëm dhe nga ai aspekt nuk ka nevojë për rebalanc të buxhetit, vlerësoi ministri i Financave, Dragan Tevdovski, duke treguar se analiza gjithësesi se bëhen dhe nëse konsiderohet se duhet të bëhen disa korrigjime, kjo do të kumtohet. "Të gjithë indikatorët makroekonomikë janë të shkëlqyeshëm dhe janë pozitivë dhe lëvizin në kahje pozitive. prodhimtaria industriale e publikuar javën e kaluar tregoi rritje prej 8 për qind në krahasim me korrikun e vitit të kaluar, ndërsa për shtatë muajt e këtij viti rritje prej 5.6 për qind, që tregojnë se në vitin 2018, industria seriozisht po fillon të rritet në krahasim me gjendjen e vitit 2017. Gjithashtu, eksporti është i fuqishëm dhe është më i lartë prej 10 për qind sipas muajve të ndryshëm, diku edhe më i lartë. Kreditimi është i fuqishëm, inflacioni është tërësisht nën kontroll. Më pas, tek tatimet, të cilat janë indikatorët më të mirë nëse subjektet ekonomike e lëvizin ekonominë dhe -punojnë, ka pagesë të shkëlqyeshme dhe rritje serioze, në pajtim me projeksionet, e diku edhe më të larta. E tërë kjo tregon se likuiditeti i buxhetit është i shkëlqyeshëm dhe sipas të gjitha gjasave për herë të parë pas shumë viteve kemi likuiditet të jashtëzakonshëm të buxhetit dhe mund të realizojmë gjithçka, përkatësisht nuk ekziston asgjë që pret në arkën e Ministrisë së Financave", deklaroi ministri i Financave, Dragan Tevdovski, duke u përgjigjur në pyetje të gazetarëve pas nënshkrimit të marrëveshjeve me komunat në kuadër të projektit me Bankën Botërore. Me këtë rast, ai shtoi se nga ky aspekt nuk ka nevojë për rebalanc, por siç theksoi ai, gjithësesi bëjmë analiza dhe nëse konsiderojmë se duhet të bëhet ndonjë korrigjim, atëherë do të dalim dhe do të kumtojmë. (Z.V)

EDHE PAGA E PUNËTORËVE TË SHËNDETËSISË RRIETET PËR 5 PËR QIND

# SPECIALISTËVE U PREMTOHET PAGË PREJ 100 MIJË DENARË

Me këtë marrëveshje, prej muajit të ardhshëm, kuadri i mesëm mjekësor do të marrë plus nga 1500 denarë, mjekët specialistë në klinikat interne universitare do të marrin plus 3756 denarë, mjekët specialistë në spitalet e përgjithshme nga 4060 denarë, ndërsa për mjekët specialistë në klinikat kirurgjike rroga do të jetë më e lartë për 4548 denarë

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 5 shtator - Me rritjen e kryegjësë për përlogaritje të pagës prej 5 për qind, së bashku me kujdestaritë, specialistët do të marrin 52.000-53.000 denarë, ndërsa targeti ynë është 100.000 denarë. Këtë e theksoi kryeministri Zoran Zaev, i cili tha se këto janë mjete të mëdha, ose 22-23 milionë denarë. "Besoj se këtë target do ta arrijmë. Në fakt jam i bindur se do ta arrijmë. Dëshira ime është që nga 1 janari të arrihet. Nëse arrijmë këtë ta realizojmë do të isha shumë i gëzuar, nëse jo - në pajtueshmëri të performancave dhe të hollave të cilat i kemi në dispozicion në buxhet, e bëjmë hapin e parë me siguri deri në 80.000 denarë dhe



menjëherë në gjysmëvjetorin e dytë të arrijmë deri në 100.000 denarë", theksoi Zaev. Sipas tij, kjo do të thotë që më shumë specialistë të qëndrojnë në shtet, të mos largohen. "Bëjmë gjithçka, punojmë në ato problematike se si t'i sjellim vendimet, ndërsa vendimet janë në shtator, për shkak të asaj se po përgatitet buxheti për vitin 2019 dhe menjëherë do t'i kumtojmë përmes mediave deri tek qytetarët", tha Zaev, duke potencuar se në vijim janë negociatat dhe të gjithë ato performanca të cilat do të thonë kurtime serioze në buxhet dëshirojnë t'i rialokojnë, të motivojnë para së gjithash shëndetësinë publike, por edhe kategoritë më të rrezikuara në shtet. Deklaratat në fjalë Zaevi i tha sot, me rastin e firmosjes së Marrëveshjes për përcaktimin e rrogës më të ulët për shkallë më të ulët të kom-

plikueshmërisë dhe për mënyrën e zhvendosjes dhe pagesës së rrogave në veprimtarinë e shëndetësisë nga ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe dhe kryetari i Sindikatës së pavarur për shëndetësi, farmaci dhe mbrojtje sociale, Lubisha Karanfilovski.

Me këtë marrëveshje, prej muajit të ardhshëm, kuadri i mesëm mjekësor do të marrë plus nga 1500 denarë, mjekët specialistë në klinikat interne universitare do të marrin plus 3756 denarë, mjekët specialistë në spitalet e përgjithshme nga 4060 denarë, ndërsa për mjekët specialistë në klinikat universitare për sëmundje kirurgjike rroga do të jetë më e lartë për 4548 denarë. Ministri Filipçe tha se me nënshkrimin e Marrëveshjes së sotme hapet rruga formale për rritje të rrogave të të gjithë të punësuarve

në shëndetësi për pesë për qind, përkatësisht rritje e rrogës bazë për përlogaritje të rrogës për të punësuarit në EPSH nga 12.654 denarë në 13.286 denarë. Theksoi se rritja do të fillojë të zbatohet me pagesën e rrogës së shtatorit dhe se kjo do të thotë realizim i edhe një pike nga Programi për punë të Qeverisë. Kryetari i Sindikatës së pavarur për shëndetësi, farmaci dhe mbrojtje sociale, Lubisha Karanfilovski tha se nënshkrimi i Marrëveshjes paraqet konfirmim për dialog të mirë dhe të suksesshëm mes partnerëve social, ndërkaq për ta si Sindikatë përfitim edhe më i madh për bazë të rrogës së të punësuarve.

"Përfitimi më i madh është përmbushja e premtimit të Qeverisë për këtë rritje të rrogave, ndërsa për ne si Sindikatë është që kjo ngritje u referohet të gjithë të punësuarve në shëndetësi", tha Karanfilovski dhe potencoi se e përshëndetë aktivitetin e këtitill të Qeverisë. Ai theksoi se në tryezën negociuese me Ministrinë e Shëndetësisë janë vendosur tashmë edhe disa korrigjime të koeficienteve të infermiereve me arsim të mesëm dhe korrigjim i koeficienteve të mjekëve specialistë. Karanfilovski përkujtoi se në fazën e parë ka pasur rritje sipas bazës së përqindjeve të kujdestarive të mjekëve specialistë, për punë në ndërrim të natës, si dhe korrigjim të koeficienteve të specialistëve nga sanitarja...

STUDENIÇANI DHE ZHELINA PJESË E PROJEKTIT TË BANKËS BOTËRORE

## 70 milionë euro nga për infrastrukturën rrugore

Shkup, 5 shtator - Gjashtë komuna nga Maqedonia morën 290.7 milionë denarë përmes Projektit për përmirësim të shërbimeve komunale të Ministrisë së Financave dhe Bankës Botërore. Mjetet do t'i shfrytëzojnë komunat Kisella Vodë, Kavadar, Ilinden, Studeniçan, Zhelinë dhe Qendra Zhupë, kryetarët e të cilave komuna nënshkruan marrëveshje në Ministrinë e Financave me ministrin Dragan Tevdovski dhe drejtorin e zyrës së Bankës Botërore në Maqedoni, Marko Mantovaneli. Do të realizohen tetë projekte të cilat parashohin ndërtim dhe rikonstruim të rrjetit rrugor lokal, kanalizimit atmosferik dhe rikonstruim të shkollave fillore. "Nënshkrimi i marrëveshjeve për tetë projekte të reja kapitale në gjashtë komuna, nga katër rajone të ndryshme është treguesi më i mirë se an-



gzhohemi për zhvillim dhe për shërbime më të mira komunale njëjtë për të gjitha komunat në Maqedoni. Përmes Projektit për përmirësim të shërbimeve komunale që Ministria e Financave e zbaton me mbështetje të Bankës botërore insistohet që përmes investimeve në të mira kapitale - së pari qytetarët të marrin shërbime më të mira komunale dhe së dyti,

të zhvillohet ekonomia lokale", tha Tevdovski. Drejtori i Zyrës së Bankës Botërore, Mantovaneli theksoi se ky është program afatgjatë dhe se këto gjashtë marrëveshje janë të parat nga faza e dytë e Projektit. "Për ne janë të rëndësishme shërbimet komunale sepse ato janë më të afërta me qytetarët dhe konsiderojmë se këtu mund të kontribuojmë më së

shumti për qytetarët e Maqedonisë", tha Mantovaneli, duke shtuar se sa më të mira të jenë shërbimet komunale, aq më të mira janë kushtet për përmirësim të cilësisë së punës së subjekteve afariste dhe qytetarëve. Kryetarët e komunave shprehën kënaqësi nga nënshkrimi i marrëveshjeve. Ata i theksuan projektet për çka do t'i shfrytëzojnë mjetet, duke thënë se edhe më tutje aktivisht di të paraqiten për pjesëmarrje në programe në mënyrë që të realizojnë projekte që do t'i përmirësojnë kushtet në komuna. Projektin për përmirësimin e shërbimeve komunale e zbaton Ministria e Financave me mbështetje të Bankës Botërore, si dhe të BE-së përmes IPA-s. Deri më tani në kuadër të këtij projekti janë realizuar mbi 70 projekte kapitale në mbi 40 komuna. (Z.V)

VETËM SHKUPI ME QENDËR PËR TRAJTIMIN E VARËSVE NGA DROGA

# PËR NARKOMANËT S'KA KUSH KUJDESET

Nga janari i 2016-ës deri në qershor të këtij viti janë regjistruar 82 raste të mbidozës në Klinikën Universitare të Toksikologjisë, nga të cilat 11 janë gra dhe një adoleshente. 36 raste janë rezultat i mbidozës me heroinë dhe 46 me metadon

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 5 shtator - Trendi i rritjes së përdoruesve të substancave narkotike është i dukshëm në Maqedoni. Nga janari i 2016-ës deri në qershor të këtij viti janë regjistruar 82 raste të mbidozës në Klinikën Universitare të Toksikologjisë, nga të cilat 11 janë gra dhe një adoleshente. 36 raste janë rezultat i mbidozës me heroinë dhe 46 me metadon. Nga shoqata HOPS dhe Shoqata e Toksikologjisë në Shkup thonë se dita-ditës po rritet numri i rasteve të përdoruesve të substancave narkotike, ndërsa kërkojnë të merren masa për parandalimin e tyre, me çka po kërcënojnë jetët e tyre.

"Shërbimet e Ndhimës së Shpejtë, shërbimet mjekësore kujdestare dhe Qendrat urgjente edhe gjatë dyshimit më të vogël të mbidozës me ekstaza, duhet ta përdorin preparatin 'Nalokson', i cili duhet të bëhet i arritshëm në bashkësitë të cilat përdorin droga ekstaza. Kompanitë farmaceutike të cilat e prodhojnë dhe përfaqësojnë e tyre ligjor duhet ta regjistrojnë ilaçin, ndërsa Ministria e Shëndetë-



sisë të lejojë qarkullim të lirë të të njëjtit pa recetë, me çka ai do të mund të blihet edhe në barnatore" thonë në deklaratë të përbashkët nga shoqata Hops dhe Shoqata e Toksikologjisë, ndërsa theksohet se mbidozat më së shumti ndodhin gjatë organizimeve muzikore dhe të ngjashme. "Institucionet kompetente duhet të krijojnë një sistem efektiv për evidentimin e rasteve të mbidozës. Njerëzit që kanë ndër mend të përdorin çdolloj droge duhet të informohen për veprimin, për pasojat e mundshme me qëllim për të zvogëluar dëmin. Qytetarët në rast dyshimi për mbidozë në mjedisin e tyre, menjëherë

duhet të thërrasin ndihmën e parë dhe ndihmën mjekësore emergjente", thuhet në deklaratë.

Profesori universitar i psikologjisë, Arafat Shabani, thotë se problemi është te kompleksi i jetesës së njeriut, sidomos brenda shoqërisë dhe mos funksionimit të sistemit

të mekanizmave mbrojtëse. "Shoqëria, shteti merret me probleme të tjera, sikur kanë harruar parandalimin e problemeve që e prekin rininë tonë dhe në përgjithësi shoqërinë. Dihet që problemet e shoqërisë reflektohen në jetën tonë, por te ne është kompleks t'u dilet në

ndihmë një shoqërie të caktuar që kanë probleme. Kjo vjen si rezultat i kompleksit të jetesës me atë njeri apo shoqëri. Por ajo që e çon njeriun drejt veprimeve të këqija është thjesht nga kompleksi i jetesës që do të thotë ka mungesë të sigurimit shëndetësor, social, etj", thotë Shabani. Ai shton se gjegjësisht me fëmijët duhet të punohet shumë që të mos bien pre e konsumit të drogave. Shabani ngrre alarmin edhe për mungesën e qendrave rehabilituese në qytetet jashtë Shkupit. "Të ketë institucione të posaçme edhe në qytete të tjera të vendit për trajtimin e njerëzve me narkomani. Këtu nuk bën pjesë vetëm ata që konsumojnë substanca narkotike, por edhe ata të varurit nga alkooli. Te ne ndodh që një pacient të jetë pjesë e institucioneve për rehabilitim vetëm atëherë kur kërkon ndihmë nga mjeku amë dhe ai e dërgon në qendër për rehabilitim. Në aspektin psiko-social, nuk kemi institucione përkatëse që kujdesen për këtë kategori të njerëzve", thotë Shabani.

## NDRYSHIMET E LIGJIT PËR ILAÇE VETERINARE KALUAN NË QEVERI

Qeveria në seancën e djeshme i solli ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për preparate veterinarë mjekësore, qëllimi i të cilit është mbrojtja e shëndetit dhe interesave të konsumatorëve, ngritja e shkallës së mbrojtjes shëndetësore dhe mirëqenies së kafshëve, si dhe siguri i klimës përkatëse afariste për operatorët e biznesit. Siç kumtoi Ministria e Bujqësisë, me ndryshimet dhe

plotësimet sigurohet rregullimi i detajuar i vendosjes në qarkullim, dhënies dhe përdorimit të preparateve veterinarë-mjekësore me definim të detajuar të cilat edhe në kushte të tilla mund të shfrytëzohen, kush mund t'i shfrytëzojë dhe te cilat lloje të kafshëve. Rriten edhe obligimet e personave profesionalë që i vendosin në qarkullim dhe i shfrytëzojnë ilaçet veterinarë.

NËSE NË MAQEDONINË LINDORE FUNKSIONOJNË DHJETËRA KOOPERATIVA

"Fatkeqësisht edhe këtë vit nuk kemi asnjë aplikim për kooperativë bujqësore apo mini-kooperativë. Kishim një të interesuar gjatë vitit të kaluar, por deri ku ka arritur me procedurat, ende nuk ka asnjë informatë kthyese. Këtë vit nuk ka asnjë iniciativë në këtë drejtim. Të paktën duhen 25 bujq të bashkojnë bonitetet e tyre për të formuar kooperativë bujqësore, ku bëjnë pjesë pronat, makineria bujqësore, por ka një hezitim në këtë drejtim...", thonë nga Njësia Rajonale e Ministrisë së Bujqësisë në Tetovë

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 5 shtator - Fondacioni maqedonas për zhvillim të ndërmarrësisë ka mbajtur një takim me bujqit në Tetovë ku të njëjtit janë njoftuar me beneficinet nëse ata themelojnë kooperativë

## Kooperativat bujqësore jo atraktive për Pollogun



bujqësore. Sipas organizatorëve, bujqit shumë pak kanë shfrytëzuar beneficinet dhe gjithnjë ata kanë tentuar që në mënyrë individuale të mbijetojnë dhe kanë dështuar. Prandaj, sipas tyre, duhet që bujqit në numër më të madh të organizohen dhe të aplikojnë për krijimin e kooperativës bujqësore, për të cilën ata mund të marrin edhe makineri bujqësore të nevojshme.

"Është shumë me rëndësi që të njoftohen bujqit se më mirë është që kur të vegjlit bashkohen dhe krijojnë diçka të përbashkët, sepse kanë më shumë aftësi për të ne-

gociuar, që të jenë më konkurrues në treg dhe kjo kërkon më shumë besim mes vet bujqve që do të krijojnë kooperativën, pasi ata vetë do të përcaktojnë rregullat e funksionimit të së njëjtës", tha Lazar Nedanovski, përfaqësues i Fondacionit maqedonas për zhvillim të ndërmarrësisë. Gjithsej do të financohen 20 kooperativa bujqësore, për të cilët janë ndarë një milion euro.

"Njerëzit janë të interesuar, por ekziston ndjenja e pabesisë, sepse akoma mendohet se gjatë tranzicionit, gjithçka mund të arrihet

vetëm. Tashmë ka humbur ndjenja për bashkëpunim mes njerëzve, por ne nuk duhet të dorëzohemi. Prandaj në këtë drejtim duhet të punohet më shumë. Bujqit duhet të bashkohen në sferat ku kanë interesa të përbashkëta, si qendra grumbullimi të kulturave bujqësore, shitjet dhe furnizimet", tha ai. Projekti me temë "Përkrahje për zhvillimin e kooperativës bujqësore" financohet nga ana e Bashkimit Evropian. Ndërkohë që vazhdon trendi negativ i mosinteresimit të bujqve tetovar për të mos hapur kooperativë bujqësore. Gati se dy vite pasi shteti mundësoi formimin e kooperativave bujqësore, në Tetovë ende nuk ka të formuar një të tillë nga bujqit. Përderisa në Maqedoninë Lindore kooperativat bujqësore shihen gjithnjë, në Pollog nuk ka asnjë të tillë.

"Fatkeqësisht edhe këtë vit nuk kemi asnjë aplikim për kooperativë bujqësore apo mini-kooperativë. Kishim një të interesuar gjatë vitit të kaluar, por deri ku ka arritur

me procedurat, ende nuk ka asnjë informatë kthyese. Këtë vit nuk ka asnjë iniciativë në këtë drejtim. Të paktën duhen 25 bujq të bashkojnë bonitetet e tyre për të formuar kooperativë bujqësore, ku bëjnë pjesë pronat, makineria bujqësore, por ka një hezitim në këtë drejtim. Ka që vijjnë dhe interesohen për këtë qëllim, por më pas heqin dorë. Ata mendojnë se me këtë do t'u konfiskohen pronat e tyre apo edhe lodhen nga procedurat dhe heqin dorë", thonë nga Njësia Rajonale e Ministrisë së Bujqësisë në Tetovë. Edhe pse deri më tani asnjë kooperativë bujqësore nuk është formuar në Pollog edhe krahas apeleve të Ministrisë së Bujqësisë, në qytetet e Maqedonisë Lindore tani më funksionojnë dhjetëra kooperativat e këtilla. Kooperativat bujqësore përsëri janë kthyer në bujqësinë e Maqedonisë, pasi pjesa dërmuese e bujqve veprojnë individualisht dhe nuk mund të zhvillojnë më shumë veprimtarinë e tyre pa i bashkuar forcat në një kooperativë.







# Dy rrugët e shtetit

Nga  
Blerim LATIFI



Pritet vjeshtë e nxehtë në politikën kosovare. Opozita ka paralajmëruar një kundërshtim të ashpër të ideve të Presidentit Thaçi për korrigjimin e kufijve me Serbinë, si zgjidhje për konfliktin e gjatë historik mes dy vendeve. Debatit ka filluar shumë keq. Partitë politike e kanë marrë në dorë debatin dhe tani nuk shohim gjë tjetër pos tymnajës së akuzave, fyerjeve, paranojave dhe konspiracioneve. Tipike për diskursin partiak në Ballkan. Kjo ka shkaktuar frikë dhe pasiguri te publiku.

Por, si do duhej nisur debati? Sigurisht, nga një analizë gjakftohtë dhe e specializuar e gjendjes në të cilën ndodhemi si shtet. Dhe kjo analizë, kuptohet, nuk do duhej të ishte fryt i një mendjeje individuale, por një punë e asaj që Habermas e quan "ndërveprimi komunikativ racional". Batoni do të më kritikojë se po bëj filozofi, e jo politikë. Por, unë mendoj se e ka gabim, ngaqë politika pa disa parime filozofike, shndërrohet në një lojë të pastër intrigash personale, e sot ne jemi në një situatë kur intrigat nuk duhet të kenë prioritet në raport me parimet filozofike të atij që quhet - interes shtetëror a kombëtar. Secila klasë politike e pjekur dhe e përgjegjshme do të fillonte nga një premisë e tillë.

## BLOKIMI RECIPROK

Ne kemi disa vite që dialogojmë me Serbinë, me qëllim që të normalizojmë marrëdhëniet mes dy vendeve. Por, nëse i shohim gjërat nga perspektiva e realizmit politik, mund të konstatojmë se gjendja faktike është ajo e bllokimit reciprok mes

Kosovës dhe Serbisë. Jemi në gjendjen kur, në njërin anë, Serbia nuk mund të bëjë më tutje në integrimin e saj në Bashkimin Evropian, për shkak se e ka nëpër këmbë problemin e saj me Kosovën. Ndërsa Kosova, në anën tjetër, nuk mund të bëjë më tutje në përmbylljen e subjektivitetit të saj ndërkombëtar si shtet, sepse përkrahësit e qëndrimit të Serbisë, në krye me Rusinë, janë

duke e penguar praktikisht një gjë të tillë. Ne mund të vazhdojmë të shpresojmë se një ditë do të bëhet mirë. Por, tjetër gjë është të shpresosh, e tjetër gjë të kuptosh se si janë duke rrjedhur gjërat realisht. Të kuptosh, të besosh dhe të shpresosh - këto janë tri gjëra të ndryshme, që rëndom njerëzit i ngatërrojnë. Immanuel Kant ka shkruar tri vepra të mëdha, për të qartësuar dallimin

**Përtej zhurmës partiake për patriotët dhe tradhtarët, debati dhe dilema reale rreth iniciativës së Presidentit është: të vazhdojmë me status quonë e shtetit të bllokuar nga brenda dhe nga jashtë, apo të përpiqemi të dalim prej saj për tu bërë shtet, në kuptimin e plotë të fjalës**



mes këtyre tri gjërave, ndërsa politika e mençur gjithmonë është ndërmjetësim i kujdesshëm i tyre. Duke qenë, pra, realistë, ne duhet të pranojmë se procesi i njohjes ndërkombëtare të Kosovës nuk është duke vazhduar. Foto-diplomacia e ministrave tanë të jashtëm nuk është më tepër se një vetëmashttrim. Lufta e Pacollit me Daçiqin për njohjet në Afrikë është krejtësisht e kotë. Rusia, anëtare e Këshillit të Sigurimit, na i ka mbyllur dyert e OKB-së dhe pesë vende të Bashkimit Evropian vazhdojnë të mos e njohin pavarësinë e Kosovës. Praktikisht, ato janë në anën e Serbisë, ndërsa fuqitë perëndimore që mbështesin Kosovën nuk po arrijnë t'i bindin për të ndryshuar qëndrim.

## DILEMA E PERËNDIMIT

Çfarë duhet bërë në këtë situatë? Duket se jemi para dy rrugëve. Njëra, është rruga e vazhdimit në kursin e vendnumërimit e të status quo-së, si vend i bllokuar në procesin e shtetformimit, duke rrezikuar që një ditë të përfundojmë në bashkësinë e shteteve të papërfunduara, si një vend që krahas kontestimit ndërkombëtar, ballafaqohet edhe me barrierat e brendshme të multietnicitetit jo-

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 5 shtator | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

funksional. Rruga tjetër është ajo e kërkimit të alternativave që mund të na nxjerrin nga bllokada e jashtme dhe e brendshme e shtetit.

Presidenti Thaçi ka propozuar një prej këtyre alternativave: marrëveshjen përfundimtare me Serbinë, në pakon e të cilës do të përfshihej korigjimi i kufijve dhe njohja reciproke mes dy shteteve. Pra, kjo është situata: jemi para një dileme, e cila para se të jetë e jona, duket të jetë dilemë e vetë Perëndimit, i cili, të mos harrojmë, na ka bërë shtet në vitin 2008. Në Washington ka shenja se janë duke e menduar rrugën e dytë. Nga Berlioni dhe Londra kemi qëndrime që duket se shkojnë në favor të rrugës së parë, rrugës së vazhimit të status quo-së. Franca ende është duke heshtur. Italia, po ashtu, ndërsa vendet e rajonit mbajnë veshët hapur duke pritur se çfarë do të ndodhë.

Në këtë dilemë, mos ta quajmë ende mosmarrëveshje e përçarje, qëndron rreziku për ne i pasojave të paparashikuara, marrë parasysh faktin se e gjithë historia politike e njerëzimit është një tërësi e pasojave të paparashikuara.

Një rikujtim i shkurtër: fitoret historike të Kosovës janë kryekëput rezultat i qëndrimit unik të Perëndimit për Kosovën. Pa këtë qëndrim unik, ne nuk do ta kishim intervenimin e NATO-s në pranverën e vitit 1999. Nuk është fare e vështirë të paramendohet se cilat do të ishin pasojat e mosintervenimit. Një UÇK e armatosur dobët dhe me 15 mijë ushtarë, që 20 vjet pas luftës u bënë 60 mijë, do ta kishte të vështirë të qëndronte përballë ushtrisë serbe të përbërë prej 100 mijë trupash të pajisura me njërin prej makinerive më moderne të luftës. Në dallim prej situatave të imagjinatës folklorike, në realitet lufta fitohet nga përparësia në fuqinë e grykës së zjarrit, e jo nga guximi i ndezur në kraharorin e kreshnikut. Falë qëndrimit unik të Perëndimit, u bë e mundur që në vitin 2008 Kosova ta shpallte pavarësinë dhe të merrte mbi 100 njohje nga shtetet anëtare të OKB-së. Por, ky qëndrim, në këtë rast, nuk ishte i plotë, ngaqë Spanja dhe katër vende tjera, anëtare të BE-së, nuk u pajtuan me të.

Të gjitha këto janë fakte që, duket qenë të njohura nga të gjithë, në shikim të parë duken banale, por duhet përmendur për të kuptuar idenë themelorene kemi ecur përpara saherë që Perëndimi ka qenë unik për ne. Çdoherë që Perëndimi nuk ka qenë i tillë, ne kemi ngecur në vend. Prandaj, sot, para se të na shqetësojnë thirrjet e Vetëvendosjes për dhunë revolucionare në rrugët e Kosovës, si dhe kërcë-

nimet e LDK-së, e cila në tërësi këtë debat udhëhiqet vetëm nga dëshira për t'iu hakmarrë Thaçit për inatet e së kaluarës, duhet të na preokupojë rreziku i një përçarjeje të Perëndimit për Kosovën – e cila mund të jetë refleksion i përçarjeve tjera edhe më të mëdha që po ndodhin brenda Perëndimit liberal.

Në këto përçarje, Rusia dhe regjimet tjera autoritariste të Lindjes janë duke kërkuar avantazhin e tyre gjeopolitik. Ballkani mund të jetë një nga targetet e kërkimit të këtij avantazhi, dhe këtë shumë shpejt do ta shohim në rezultatin që do të japë referendumi në Maqedoni për çështjen e emrit të saj.

#### SUSPENDIMI I PËRKOSSHËM I HASMËRIVE POLITIKE

Pra, loja gjeopolitike me të cilën kemi të bëjmë është shumë herë më e madhe prej asaj që janë duke e menduar partitë opozitare dhe mbështetësit publikë të tyre. Dhe, Presidenti Thaçi nuk është naiv që në këtë lojë të madhe të niset në një aventurë personale. Po të ishte i tillë, karriera e tij politike qëmtoi do të kishte përfunduar, sepse politika nuk është art për naivët. Kundërshtarët e Thaçit mund të mos e duan për intrigat e së kaluarës të luftës legjitime për pushtet, por, sot, secili që shqetësohet për Kosovën, nuk duhet të mendojë për "hakmarrjet personale politike". Sot, ne duhet t'i suspendojmë hasmëritë politike për hir të nxjerrjes së shtetit nga bllokimi i jashtëm dhe i brendshëm.

Presidenti mund të mos ketë afinitetin e duhur për punët prozaike të qeverisjes ekonomike, por në punët e konfliktit me Serbinë ka një përparësi qartësisht të dallueshme me të tjerët. Janë të vetmet punë që di t'i bëjë me shumë kompetencë. Natyrisht, kjo nuk do të thotë të shkojmë pas tij në mënyrë të verbër. Kjo mënyrë nuk i shërben as atij dhe askujt tjetër. Ajo që kam në mendje është ideja që t'i shikojmë gjërat jo me emocione dhe animozitete personale e partiake, por me realizmin dhe racionalitetin e asaj që njihet si arsye shtetërore. Dhe me gjakftohtësi të kuptojmë se cilat janë mundësitë pozitive, e cilat rreziqet në debatin mes alternativës së status quo-së dhe alternativave të daljes prej saj. Natyrisht, gjithmonë duke pasur vëmendjen në rrjedhat që merr dilema e Perëndimit për të ardhmen e shtetit tonë, sepse, siç thoshte Konica, dielli i shqiptarëve lind nga perëndimi. Sot, ose do të vazhdojë të lindë andej, ose forcat e errësirës kërcënojnë të vendosin mbretërinë e tyre në horizontin tonë politik.

(gazeta express)

## Luli i vocërr i shekullit të ri

Askush se njihje Lulin e vocërr të Migjenit, dhe askush mbase se njihje djalin i cili ditën e parë të shkollës e filloi në vend se me çantë të re, si gjithë moshatarët e tij, me një qese plasmasi, të cilën e kishte hedhur pas shpine. Krahët i kishte shtirë tek vendi ku zakonisht qesja mbahet me dorë dhe ecte kokë ulur. Nga dhjetëra e dhjetëra foto të fillimit të vitit shkollor mua kjo më tërhoqi vëmendjen dhe një tjetër për të cilën do flas pak më poshtë.

Pamje sa një mijë fjalë. 1. A jetojmë në shoqëri kaq të ndara mes klasash banale të pasurish dhe të varfërisht? 2. A është e mundur që në mesin tonë ende të kemi Lula të vocërr në dimensione migjeniane? 3. Dhe pyetje sa ekzistenciale aq edhe politike, a nuk jemi një shtet ku duhet të kujdesemi për të varfrit? Paralelisht me këto pyetje që ngrihen veç duke parë një foto, lexoja një tekst në mediet se si të zhduket dallimi klasor dhe një përgjigje ishte duke eliminuar arsimin privat. Sipas tekstit, sugjerohej se gjithë arsimi duhej të ishte në dorë të shtetit dhe pa pagesë dhe kështu kur studentët do të bëheshin profesionistë do të përballëshin me tregun të barabartë, e jo me (para)grykimin se nga cila shkollë vinin.

Në fakt një nismë e tillë do të vlente sepse me siguri, të paktën rrugës për në shkollë, nuk do të shihnim fëmijë me çanta të reja e ata me qese plasmasi, sepse gjithçka do të ishte falas, nga librat e deri te universiteti. E vetmja gjë që do duhej të kishin me vete do ishte dija. Po që t'i përgjigjem pyetjeve që i shtrova:

1. Po si duket po thellohet ndarja mes shtresash, ku ajo e varfra po del në sipërfaqe.

2. Thirrjet konstante për ndihmë, por dhe numri i madh i prindërve krenarë e punëtorë, por që nuk ia dalin të lidhin muajin me muaj, tregojnë se ka shumë Lula të vocërr. Aq shumë sa edhe pse jo çdo herë duken tani, por do të shfaqen më pas me përplasjet që do të sjellin në shoqëri.

3. Dhe e treta, si të përballohet kjo përplasje që do vijë e nxitur nga shumë aspekte, por baza do jetë tek moshpërndarja e drejtë e mundësive që duhet të vinë në përparim marrjes së dijes në mënyrë të barabartë.

Këtu ka shumë dorë politika. S'kemi parë projekte dhe ide se si të trajtohet ky fenomen. S'di të ketë artikullar dikush projekte dhe ide se si të ndërtohet një sistem ku arsimi të jetë i të njëjtës cilësi dhe nivel për të gjithë. Dhe mbase më e rëndësishmja, një shtet që do duhej

Askush se njihje Lulin e vocërr të Migjenit, dhe askush mbase se njihje djalin i cili ditën e parë të shkollës e filloi në vend se me çantë të re, si gjithë moshatarët e tij, me një qese plasmasi, të cilën e kishte hedhur pas shpine. JO miq, në shekullin e 21 nuk do duhej të shihja e shihnim Lulin e vocërr. Dhe tjetra që pashë, një tekst me shkronja që mirëpriste nxënësit në fillimin e vitit shkollor e që ishte përplot gabime



të kujdesej edhe për të varfrit, nuk e di a ka ide dhe projekte se si të ndihmohen prindërit dhe sidomos nxënësit që mos ndihen si Luli i vocërr pranë shokëve dhe mësuesve të tyre. Në fakt kjo çështje është tejet politike. Bazike madje për partitë kur artikulojnë premtimet dhe ideologjinë e tyre. Duan një shtet ku tregu do diktojë kushtet dhe si rrjedhojë edhe dallimin mes klasave, apo një shtet që do ndërhyjë për të tentuar të krijojë një barazi shoqërore. Elementare është kjo që them në kontekste politike, por determinuese se çfarë provinience do kenë partitë. Të cilat shpesh të kaluara në komplekse jo dhe aq politike, por historike kanë frikë të artikulojnë qartë dhe si rrjedhojë, edhe e mungesës së veprimit e dijes politike, nuk ndërtojnë politika që do të preknin direkt interesat jetike të njerëzve.

JO miq, në shekullin e 21 nuk do duhej të shihja e shihnim Lulin e vocërr. Dhe kjo çështje që është thelbësore jetike e politike duhet të trajtohet në vazhdimësi. Dhe tjetra që pashë, një tekst me shkronja që mirëpriste nxënësit në fillimin e vitit shkollor e që ishte përplot gabime. Ohhh, prapë e gjithë çështja lidhet tek vetvetja, sistemi, mënyra e punësimit, kontrollit, universitetet, niveli. Prapë e gjitha lidhet me atë se kush po na i mëson nxënësit, çfarë programesh kanë, dhe sa seriozisht punohet. E di që mund të bëhen gabime gjatë shkrimit, edhe vetë i bëj, por një rresht mirëseardhës, me shkronja të mëdha, para syve të krejt mësuesve, s'kiste se si mos binte në sy. Nuk është çështja tek lapsuset, se nuk dua të jem cinik, por tek i gjithë sistemi që në vazhdimësi duke mos pasur kujdes për detajet, për profesionaliz-



Nga  
Nazim RASHIDI

min, për edukimin e duhur, atë që bën është se vetëm riciklon dallime të mëdha klasore që lidhen me nivelin e dijes që kanë marrë nëpër shkolla. Kjo do të thotë ri prodhimi në vazhdimësi i Lulit të vocërr vetëm se në një shekull të ri. I pa edukuar si duhet, i pa barabartë ekonomikisht, i pa ditur teknologjikisht, i pa punësueshëm në tregun e punës përplot konkurrencë, krijon riciklimin e Lulave në vazhdimësi. Dhe JO, s'do duhej të ishte kështu. Dhe kush e ka lexuar "Lulin e vocërr", s'ka se si mos tromakset nga rrëfimi. Për të gjithë që e dinë e kanë harruar apo dhe se kanë lexuar, e keni më poshtë. Por kujdes se tullumbat e tij mund t'ju hanë!

#### LULI I VOCËRR

Askush s'e njef Lulin. As shokët e tij, që përpara tij lozin, nuk e njofin. Ma mirë me thanë se e njofin, por ata lozin për hesap të vet e Luli i shikon për hesap të vet. Sot gjithkush ka punët dhe telashtet e veta, ashtu dhe fëmijët, ashtu dhe Luli. More Lul! Shumë herët ke fillue me shikue punën tande!

Kur Luli hyn n'oborr të shkollës, buza i qeshet ngapak, por askuj, asnjë fjalë s'i thotë. Ecë ngadalë, tue shikue djathtas e majtas, po gjithnjë tue ecë deri sa të mbërrijë në cak të vet. Aty, te dera e rruzinës shkollore, shumë i pëlqen të qëndrojë. Aty asht caku i tij, i praruem me rrezet e ngrohta të diellit në këto ditët e vjeshtës. Mbështetet Luli për mur, grushtat e vogjël i shtje ndër xhepa, hundën picrroke të kuqun nga të ftoftit e mëngjesit ja sjell diellit dhe...shikon. Gjaja që ma tepër tërheq vëmendjen janë çizmet që i kanë të veshun disa shokë të tij. Sa të bukura janë! Si shkëlqejnë!—mendon Luli dhe pa dashje i shkojnë sytë ndër tullumbat e veta, nëpër të cilat shifen fare mirë të pesë gishtat e këmbëve të zbathuna. Nga kurreshta i afrohet një shokut që ka çizmet ma të reja. Ulet dhe shef në lustrin e çizmes kambët e veta të zbathuna—aq shumë shkëlqeshin çizmet!!! Mbasi shoku me çizme fluturoi, Luli ngadalë shkoi te caku i vet, në diell, t'i ngrohi kambët.—Por kur s'ka diell, si ia ban i shkreti Lul? Ndoshta ia bajnë hallin apostujt e mëshirës dhe të dashunis... Noshta, ndoshta... Nganjihërë i afrohet mësuesi Luli. Dhe kur Luli e ka ftyrën e dlirë dhe pa puça, mësuesi ia ledhaton faqet, gushën, e Luli i afrohet, ja merr dorën, e shikon me sy pëllumbi, dhe kishte me dashje t'i falë diçka mësuesit. Por vjolla nuk ka. Veç në i faltë tullumbat e veta, që kanë hapun gojën si me dashje me e hangër mësuesin. Po, po, tullumbat e Lulit të vocërr kanë me e hangër mësuesin. (Migjeni)

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Koha, e enjte, 6 shtator 2018

# PUNË E PAK LOJËRA! IMAZHE TË RRALLA NGA KOREJA E VERIUT

Këto fotografi mahnitëse tregojnë vështirësinë që hasin në punë njerëzit në fabrikat e Koresë së Veriut, por ka edhe nga ata që shfrytëzojnë pak kohën e lirë për disa momente argëtimi. Imazhet tregojnë se gratë me pamje solemne punojnë në fabrikat mëndafshi, pasagjerë të "shtrydhur" në trena në kryeqytetin Pyongyang dhe pushues që

zhyten në det dhe shijojnë plazhin në vendpushimin bregdetar të Wonsan. Parukeritë, parqet e lojërave, fidanishtet, shkollat dhe pishinat gjithashtu shfaqen në skicën e fotografive, të cilat vijjnë nga vendi i mbyllur, që vijon ende negociatat ndërkombëtare që synojnë lehtësimin e tensioneve në gadishullin Korean.





## “Korrigjimi i kufijve” do të thotë rikthim të tensioneve etnike

Nën zonën e paqes relative, e cila zgjati dhjetë vjet në Ballkan, tensionet etnike dhe pasionet nacionaliste janë ende të pranishme. Bisedimet e Prishtinës dhe Beogradit për normalizimin e marrëdhënieve mund të vënë paqen në provë - veçanërisht ideja e debatueshme e shkëmbimit territorial, shkruan “Stratfor”, platforma që merret me analizën gjeopolitike. “Ballkani Perëndimor është relativisht i qetë në dekadën e fundit, por përpjekjet e vazhdueshme për normalizimin e marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës mund të jenë për të krijuar kushte për një kthim të paqëndrueshmërisë politike dhe dhunës etnike në rajon”, thotë teksti i kësaj medie, transmeton Shqiptarja. “Stratfor” vlerëson se një nga temat më të diskutueshme në bisedimet e ardhshme ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel, më 7 shtator, do të jetë Asociacioni i Komunave me shumicë Serbe (AKS), duke vënë në dukje se marrëveshja u konceptua në vitin 2013, por që atëherë shumë pak është arritur. Një tjetër, temë e diskutueshme, e cila është e mundshme të flitet është “korrigjimi i kufijve” që në javët e fundit është folur nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe homologu i tij serb, Aleksandar Vuçiq. Duke shpjeguar se çfarë saktësisht do të thotë “korrigjimi i kufijve”, “Stratfor” thekson se është debatuar gjerësisht për shkëmbim terriroresh. “Ideja e shkëmbimit të terriroreve, e cila do të krijonte një Serbi dhe një Kosovë etnikisht homogjene, është diskutuar në qarqet akademike dhe politike që prej viteve ‘90. Partitë opozitare dhe politikanët në të dy anët e kanë dënuar këtë propozim, i cili mund të çojë në forcimin e nacionalistëve etnik në pjesët e tjera të Ballkanit...”, thuhet në tekst. “Stratfor” vlerëson se të dyja palët do të përpjekin të marrin sa më shumë terrirore të jetë e mundur dhe për të bërë sa më pak të jetë e mundur koncesione. “Edhe nëse arrihet një marrëveshje, e komplikuar e logjistike, problemet politike, ekonomike dhe etnike kanë bërë që shkëmbimi i madhe i terriroit të jetë vështirë i realizueshme”, sipas tekstit.

# PARISI KUNDËR NDRYSHIMIT TË KUFIJVE, RIKUJTON PARIMET E BADINTERIT

“Parisi zyrtar druan se çfarëdo ‘rivizatimi’ kufijsh do të mund të shkaktonte reaksione zinxhir në rajon, madje edhe nëse do të theksohej se kjo ka të bëjë vetëm me marrëdhëniet midis Beogradit e Prishtinës”, raportohet të jetë thënë nga autoritetet franceze

Është deklaruar edhe Parisi në lidhje me çështjen e aktualizuar së fundi për rivizatimin e kufijve midis Kosovës e Serbisë. Franca, njësoj si Gjermania, është kundër ndryshimit të kufijve ndërmjet këtyre dy vendeve ballkanike. E përditshmja e Beogradit, “Novosti” citon burime sipas të cilave në Konferencën me ambasadorët e Francës, të mbajtur javën e shkuar, në të cilën ishte i pranishëm edhe presidenti francez, Emanuel Macron, u tha preraz se ky vend është kundër çfarëdo ndryshimeve të kufijve në rajon. Në lidhje me këtë çështje, qëndrimi i Parisit madje është edhe më i prerë se ai i Berlinit, transmeton Koha.net. “Parisi zyrtar druan se çfarëdo ‘rivizatimi’ kufijsh do të mund të shkaktonte reaksione zinxhir në rajon, madje edhe nëse do të theksohej se kjo ka të bëjë vetëm me marrëdhëniet midis Beogradit e Prishtinës”, raportohet të jetë thënë nga autoritetet franceze. Kjo, në radhë të parë ka të bëjë me situatën sipas të cilës Republika Serpska (BeH) do të provonte shembullin e veriut të Kosovës. Francezët u përm-



Johannes Hahn, komisionari për Zgjerim i BE-së, nuk pret që të premten presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, të arrijnë marrëveshje për çështjet në dialog mes Prishtinës dhe Beogradit. Hahn nuk pret marrëveshje në raundin e ri të dialogut, dhe thotë se rruga drejt marrëveshjes do të marrë disa muaj



bahen me rigorozitet parimeve të Badinterit sipas të cilave kufijtë e republikave brenda ish-Jugosllavisë

(sipas Kushtetutës së vitit 1974) të shpallen kufij të shteteve.

Sipas kësaj gazete serbe, marrëveshja për Kosovën do të marrë formën përfundimtare pikërisht në Francë, në margjinat e kremtimit të 100-vjetorit të ngadhënjimit të aleatëve në Luftën e Parë Botërore, më 11 e 12 nëntor në Paris. Rundi i ri i bisedimeve të Brukselit në nivelin e presidenteve, midis Hashim Thaçit të Kosovës, dhe Aleksandar Vuçiqit të Serbisë, me ndërmjetësimin e kryediplomates së BE-së, Federice Mogherini, është paralajmëruar të mbahet këtë të premte, më 7 shtator.

Ndërkohë, Johannes Hahn, komisionari për Zgjerim i BE-së, nuk pret që të premten presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, të arrijnë marrëveshje për çështjet në dialog

mes Prishtinës dhe Beogradit. Hahn nuk pret marrëveshje në raundin e ri të dialogut, dhe thotë se rruga drejt marrëveshjes do të marrë disa muaj. Siç transmeton “Shqip”, ai gjatë vizitës së tij në Tiflisit, të premten, tha se në raundin e ri të dialogut nuk presin ndonjë “finalizimin”, për shkak se është shumë herët.

Ai thotë se marrëveshja mes Prishtinës dhe Beogradit do të zgjasë disa muaj, dhe thekson se të dy palët duhet të vazhdojnë të punojnë për një marrëveshje. Sipas tij, ka shumë më tepër pyetje që duhet të zgjidhen lidhur me debatin e fundit publik, i cili ka qenë korrigjimi i kufirit. Në raundin e ri të dialogut me Përfaqësuesin e Lartë të BE-së, Federica Mogherini në Bruksel, Hahn pret që të diskutohet për çështjet aktuale politike që kanë ngjallur debat.

## EDHE BUJANOVCI I DEL KUNDËR IDESË SË THAÇIT

### Mos e jepni veriun për neve

Shaip Kamberi, kryetar i Komunës së Bujanovcit, ka deklaruar se nuk janë për shkëmbimin e terriroreve me Serbinë. Ai po tha se ideja e bashkimit me Kosovën po nxit emocione te banorët në Luginë dhe Kosova në këtë pikë të dialogut duhet të caktojë objektivat e veta. “Kur të del një ide atraktive se do të bashkohemi me shqiptarët, nxit emocione dhe shprese, por ne nuk i përcaktojmë vijat e kuqe që Kosova i përcakton. Kosova duhet të përcaktojë cilat duhet të jenë objektivat e saj në këtë dialog. Kosova duhet të kërkojë të pagjeturit”, shtoi Kamberi. Kamberi tha se ata nuk kanë kërkuar të japin Veriun dhe të marrin Luginën “Ne nuk kemi thanë që ju jepni Veriun dhe merreni Luginën dhe nëse Bashkësia Kombëtare është e pajtimit, Lugina e Pre-

shevës ka vullnet të bashkohet me Kosovës dhe për neve nuk ka asnjë moment nuk kemi vullnet me e nda popullatën dhe cila është më e mirë për Kosovën le të vendos ajo vetë. Kosova e ka obligim kombëtar që Luginën e Kosovës e ka obligim të diskutojë nëse jo për shkëmbim terriroresh atëherë për të drejtash. Kosova duhet të ketë përfundimisht duhet të vendosë kushte për këtë pjesë të dialogut” ka thënë Kamberi. Gjithashtu Kamberi tha se çështja e shkëmbimit të terriroreve është e dëmshme për Luginën e Preshevës dhe në Luginë nuk janë për ndarje të popullatës.

“Ajo që askush në Luginë nuk e do shkëmbimin e terriroreve dhe kjo është shumë e dëmshme me ne, në këtë aspekt Kosova duhet të tregojë se cilat janë linjat e kuqe të

këtij dialogu dhe në këtë rast vlen ajo shprehje “mos i beso grekut edhe kur sjellë dhurata” dhe është Kosova është ajo që duhet të vendosë. Sipas statistikave ka rreth 62 për qind shqiptarë dhe 10 për qind rom dhe kemi në përgjithësi rënie të popullsisë dhe jo vetëm të asaj shqiptare”, tha Kamberi. Këto deklarata Kamberi i dha në tryezën “Loja me Kufij: Luftë apo Zgjidhje në Ballkan?” do të diskutohet për qëndrimin e partive politike të Kosovës rreth kësaj ideje, koston e një opsioni të tillë për Kosovën si dhe të ardhmen e asetëve ekonomike e strategjike të Kosovës që gjenden matanë lumit Ibër. Folës në tryezën e moderuar nga Jeta Xharra do të jenë: Avdullah Hoti, shef i grupit parlamentar të LDK; Albin Kurti, kryetar i LVV, Shaip Kamberi, kryetar i Komunës së Bujanovcit, Fehmi



Beja, kryetar i Komunës së Medvegjës, Nenad Rashiq, kryetar i PDP; Ahmet Isufi, nënkryetar i AAK-së, si dhe deputetë, ish-deputetë dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Gjatë tryezës do të emetohen video të shkurta të pikëpamjeve të analistëve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Europa e rajoni të dhëna ekskluzivisht për këtë tryezë. Tryeza diskutimi “Loja me Kufij: Luftë apo Zgjidhje në Ballkan”, organizohet nga Emisioni “Jeta në Kosovë”.

## Ushtarët izraelitë plagosin gazetarët e AA-së dhe AFP-së



Ushtarët izraelitë kanë plagosur me plumba gome 3 gazetarë, përfshirë edhe fotoreporterin e AA-së të cilët po ndiqnin ndërhyrjen e ushtarëve izraelitë ndaj palestinezëve në Ramallah, që ndodhet në Bregun Perëndimor të okupuar. Si pasojë e hapjes së zjarrit me plumba gome janë pla-

gour fotoreporterit i AA-së Isam Rimavi, gazetarët e agjencisë së lajmeve franceze AFP, Abbas Mumini dhe britaniku Joe Dyke të cilët po ndiqnin ngjarjet në rajonin Ras Karka në perëndim të Ramallahut. Ndërkohë bëhet e ditur se gjendja shëndetësore e gazetarëve është e mirë. Theksohet se kolonët he-

brenj që prej disa kohësh për të ndërtuar vendbanime të reja janë duke zhvilluar punime për hapjen e rrugëve mbi territoret e palestinezëve në Ras Karka. Si pasojë e kësaj po ndodhin përleshje mes palestinezëve që reagojnë ndaj kësaj situatë dhe ushtarëve izraelitë të cilët mbrojnë kolonët hebrej.

## MË SHUMË KONTROLL NDAJ GOOGLE!



Në dy dekada Google është zhvilluar nga një firmë e krijuar në një garazh në Kaliforni në koncernin më të fuqishëm të internetit në botë. Për shkak të pushtetit që ka Google duhet të na interesojë të gjithëve

Kur presidenti amerikan Donald Trump godet Google, e bën këtë me sjelljen tipike alla Trump. Një njeri egoman kërkon që bota t' i përshtatet ideve të tij, dhe jo anasjelltas. Një gjë Trump megjithatë e ka kuptuar, pushtetin e madh që ka Google. Algoritmet e Google vendosin tashmë cilat lajme lexohen dhe cilat kalojnë pa u ndier. Shefat e koncernit pretendojnë madje se nuk ka pse t' i vrasë ndërgjegjja, sepse aty nuk manipulohet asgjë. Gjithçka zhvillohet sipas një principi, në sipërfaqe da-

lin ato gjëra që u interesojnë njerëzve më shumë. Relevanca është principi bazë. Vetëm me këtë mënyrë koncerni është bërë kaq i madh. Por kjo nuk mund të vazhdojë gjithë kohën. Google është përpjekur gjithnjë të prezantojë veten si "shok" dhe "partner" i mirë. Në përshtatje me moton e ditëve të para të themelimit: "Don't be evil" - "Mos u bëj i keq". Kjo moto është për t'u mbajtur mend sepse përmban brenda vetes shumë moral. Ekziston e mira, ekziston edhe

e keqja. Dhe ne, thonë themeluesit e Google, kemi marrë vendim të jemi të mirë. Ndërkohë Google e ka ndryshuar sloganin. Tani ai është: "Do the right thing" - "Bëj atë që duhet". Në shikim të parë duket po aq simpatik sa slogani i mëparshëm, megjithatë nuk është ashtu. Nëse për shembull do të pyesnit Donald Trumpin çfarë mendon ai për "the right thing". Google sot është në çështjet e moralit shumë më fleksibël se sa në vitet e fillimit. Kjo duhet të trembë të gjithë

ata që besojnë se interneti do të bëhet vendimtar për të ardhmen e demokracisë dhe shoqërisë sonë. Ne na duhet dikush që kontrollon mirë këtë gjë. Që kontrollon neutralitetin e Google dhe respektimin e neutralitetit. Jo autoritete, politikanë por institucione neutrale. Për shembull një fondacion. Ai duhet të mbrojë Google nga përpjekjet për t' u kthyer në mish për top për politikën dhe ekonominë. Sepse sa më pak konkurrencë ekziston në internet aq më të prekshme bëhen këto rreziqe. Donald Trump do të preferonte shumë që t' ia shkruante me ligje motorëve të kërkimit idetë që ka ai për motorët e kërkimit. Që Google ka mbetur neutral, ka ndodhur deri tani prej vetë sipërmarrjes. Po ashtu siç duhet të mbrohet vetë nga përpjekjet dhe sulmet për manipulim. Kurse ne përdoruesit duhet të besojmë se koncerni do vërtet që të mbetet neutral. E rrezikshme kjo është kur sipërmarrja ka sot një pozicion gati monopolist. Prandaj Google duhet të gëzohet edhe vetë të ketë një kontroll të pavarur nga jashtë, dhe të mos vazhdojë ta pengojë këtë me forcë si deri tani. (DW)

### RUSIA I KËRKON KOMPANISË GOOGLE TË MOS NDËRHJË NË ZGJEDHJE

Zyrtarët rusë kanë thënë të kenë paralajmëruar gjigantin amerikan të internetit, Google kundër "ndërhjës" në zgjedhjet lokale të planifikuara për këtë vikend, me arsyetimin se po i lejon armikut të Kremlinit, Aleksei Navalny të postojë video duke bërë thirrje për protesta masive në YouTube. Përfaqësuesit e Komisionit Zgjedhor në Rusi, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm dhe vëzhgues shtetërorë në internet kanë diskutuar për pakënaqësitë e tyre kundër kompanisë Google, pjesë e së cilës është edhe YouTube,

gjatë një seance në Dhomën e Ulët të parlamentit rus. Zyrtarët kanë pretenduar se Navalny përdor YouTube për të shpërndarë informacion që është "jologjor" në Rusi dhe kanë paralajmëruar se kompania Google mund të ndiqet penalisht nëse nuk vepron për të ndaluar këta hapa. Navalny ka përdorur kanalën e tij në këtë platformë për t'iu bërë thirrje rusëve që të protestojnë kundër reformave për pensione më 9 shtator, ditën e njëjtë kur disa rajone ruse dhe Moska zgjedhin zyrtarët lokalë dhe ata rajonalë.

## Fushatë e re për shkëputje të Katalonjës



Lideri katalonas, Kim Tora ngriti sërish fushatë për shkëputje të Katalonjës nga Spanja, njëkohësisht duke e hedhur poshtë ofertën e qeverisë spanjolle për referendum për autonomi më të madhe. Tora mbrëmë tha se mandati, të cilin ia dhanë qytetarët më 1 tetor, është ende në fuqi dhe se insiston ta përmbushë. Ai në teatrin në Barcelonë mbajti fjalim nën titullin "Momenti ynë". Tora tani kërkon referendum të ri, që do ta njëhte Spanja. "Ajo është mënyra e vetme që të ripërtërihet mandati që e fituam", tha ai, pas pothuajse pesë muajve pasi që është zgjedhur për funksionin e kryetarit të qeverisë. Paraardhësi i tij, Karles Puxhdemon, në tetor të vitit 2017 organizoi referendum për pavarësi. Shumica votoi për shkëputje, por kundërshtarët e pavarësisë nuk votuan, sepse qeveria e Spanjës dhe Gjykata kushtetuese e ndaluan referendumin.

## Turqia në prag të krizës së re

Në Turqi, inflacioni i lartë në rritje dhe rënia e vlerës së monedhës po nxisin frikën se vendi është në prag të një krize të re financiare dhe ekonomike. Vendosi muajin e kaluar e tarifave tregtare nga Presidenti Donald Trump, pas vazhimit të ndalimit të pasorit amerikan, Andrew Brunson, u bë shkak për zhvlerësimin e monedhës turke. Banka Qendrore Turke premtoi të përdorë të gjitha mjetet në dispozicion të saj dhe të

riformulojë politikën e saj monetare në një takim të 13 shtatorit ku do të diskutohet mbi normat e interesit. Megjithatë, analistët paralajmërojnë se një rritje agresive e normave të interesit mund të mos jetë e mjaftueshme për të frenuar inflacionin apo për të mbrojtur lirën.

"Është e pamundur të mos e ndiejmë inflacionin. Duhet të shpenzojmë dyfishin e atyre kemi fituar, pagat tona mbeten të njëjta,

çfarë do të ndodhë? Situata po përkeqësohet dhe po bëhet gjithnjë e më e vështirë", thotë Leyla Ates, një pensioniste. "Turqit nuk e meritojnë këtë. Ne jemi më shumë se të prekur, po jetojmë një makt", thotë ajo.

Vendosi muajin e kaluar e tarifave të tregtisë nga Presidenti Donald Trump, pas vazhimit të ndalimit të pasorit amerikan, Andrew Brunson, u bë shkak për zhvlerësimin e monedhës turke. Brunson



është në gjyq nën akuza për terrorizëm, një rast që Uashingtoni e quan të motivuar politikisht. Duke injoruar presionin e Shteteve të Bashkuara, kreu i gjykatës së apelit

të Turqisë, Rustu Cirit, mbështeti dje refuzimin e Turqisë për lirin e Brunsonit, duke thënë se liri i tij është një çështje vetëm e gjyqësorisë.

Koordinatori në Koalicionin Free Rohingya, Maung Zarni, i krahasoi mizoritë e Mianmarit ndaj muslimanëve të Arakanit me ato të kryera nga Gjermania naziste

# MIANMARI, GJERMANIA NAZISTE E DITËVE TONA!

Mizoritë që shënjestruan minoritetin Rohingya (muslimanët e Arakanit) të Mianmarit janë të ngjashme me ato të kryera nga Gjermania naziste, tha një aktivist i shquar budist për të drejtat e njeriut. Duke folur për Anadolu Agency (AA) në Kent të Britanisë, Maung Zarni, koordinator në Koalicionin Free Rohingya, tha se bashkësia ndërkombëtare duhet të veprojë ndaj Mianmarit, vendit të tij të origjinës.

Komentet e Zarnit vijnë pasi OKB publikoi një raport këtë javë në të cilin ka dokumentuar përdhunime në masë, vrasje, përfshirë foshnjat dhe fëmijët e vegjël, rrahje brutale dhe zhdukje të kryera nga forcat shtetërore të Mianmarit. Në raport, hetuesit e OKB-së thanë se shkeljet e tilla mund të kenë përbërë krim kundër njerëzimit. "Ne kemi një situatë në të cilën një shtet anëtar i OKB-së i drejtuar nga një fituese e Çmimit Nobel të Paqes, Aung San Suu Kyi, dhe partnerët e saj në pushtet, gjeneralë ushtarakë birmanë, cilësohet nga organi më i besueshëm dhe më i lartë i autoriteteve të të drejtave të njeriut në botë i ngjashëm me Gjermaninë naziste", tha Zarni. "Gjenocid është ajo që bënë nazistët. Gjenocid është ajo që ndodhi në Ruandë, në Kamboxhia, ose ndaj muslimanëve boshnjakë", shtoi ai. Zarni nënvizoi se kur një rast cilësohet si "gjenocid", përgjegjësia për t'u marrë me të qëndron te të gjitha shtetet anëtare të OKB-së. "Detyrimi më i lartë politik dhe moral qëndron në Këshillin e Sigurimit (OKB)", vlerësoi ai.

Ai tha se formimi i një gjykatë penale ndërkombëtare siç është bërë për Ruandën ose Bosnjën nuk do të ishte i mjaftueshëm, por komuniteti Rohingya ka nevojë për "një rajon të mbrojtur ku ata mund të jetojnë në mënyrë të sigurt si qenie njerëzore normale dhe të denja". Misioni i pavarur ndërkombëtar për vlerësimin e fakteve në Mianmar, i formuar nga Kombet e Bashkuara (OKB), ka kërkuar të hënën ndjekjen penale të kreut ushtarak të ushtrisë së Mianmarit (Tatmadaw), ndër të cilët edhe të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, Min Aung Hlaing, para Gjykatës Ndërkombëtare Penale për gjenocidin e kryer mbi muslimanët Rohingya. "Pritja ime, në një botë ideale, është që Këshilli i Sigurimit i OKB-së të autorizojë një



MAUNG ZARNI

Rohingyat janë duke u pastruar dhe qëllimi përfundimtar në zbatimin e sanksioneve ndaj Mianmarit duhet të jetë ndryshimi rrënjësor i politikave të shtetit të Birmanisë dhe ndryshimi i strukturave që janë mobilizuar nga ushtria dhe krijuesit e opinionit publik për të shtypur, përndjekur dhe asgjësuar këtë popull

formë të ndërhyrjes në mënyrë që mizoritë të mund të ndalen dhe komunitetit Rohingya të mund t'i kthehet vendi i tyre dhe të lejohet të jetojë me dinjitet dhe në siguri", tha Zarni.

## SANKSIONET

Zarni vuri në dukje se tani ka më shumë Rohingya që jetojnë jashtë Mianmarit sesa ata që kanë mbetur në vend pas dekadave të dhunës, por veçanërisht pas sulmit masiv që u nis kundër tyre në gusht të vitit të kaluar. Duke nënvizuar se bashkësia ndërkombëtare duhet të vendosë sanksione ndaj qeverisë dhe ushtrisë së Mianmarit, Zarni u shpreh se politika e përjashtimit kundër muslimanëve të Arakanit duhet të përfundojë. "Muslimanët Rohingya janë duke u pastruar dhe qëllimi përfundimtar në zbatimin e sanksioneve ndaj Mianmarit duhet të jetë ndryshimi rrënjësor i politikave të shtetit të

Birmanisë dhe ndryshimi i strukturave të cilat janë mobilizuar nga ana e ushtarëve të Birmanisë dhe krijuesit e opinionit publik për të shtypur, përndjekur dhe asgjësuar këtë popull", shtoi Zarni. Sanksionet e shumëfishta duhet të ofrojnë mbrojtje ndërkombëtare për komunitetin Rohingya dhe të krijojnë "një rajon autonom ku ushtria e Birmanisë nuk do të lejohet të vazhdonte mizoritë", tha ai.

## ZGJIDHJA

Zarni u shpreh se Mianmari ka katër shtylla kryesore: ushtrinë, rendin budist, partitë politike dhe publikun. "Të katër këto institucione të mëdha, kanë refuzuar kategorikisht komunitetin Rohingya. Ne u themi atyre se nuk i përkasin Birmanisë, se nuk i duam në Birmani", tha Zarni. Ai shtoi se zgjidhja e problemit nuk qëndron në Mianmar, por duhet të formu-

lohet ndërkombëtarisht dhe brenda institucioneve të OKB-së.

## THIRRJE TURQISË PËR NDIHMË

Zarni vuri në dukje se presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan dhe qeveria turke "kanë qenë jashtëzakonisht të zëshme dhe përkrahëse për popullin Rohingya". "Kjo është koha që Turqia të tregojë udhëheqje serioze morale dhe politike", vlerësoi ai. Duke theksuar se Këshilli i Sigurimit i OKB-së është në "koma" dhe "i paralizuar" pasi nuk mund t'i zgjidhë problemet, Zarni tha se Turqia mund të ndihmojë me të vërtetë në rastin e Mianmarit, duke "krijuar një koalicion të qeverive muslimane dhe jomuslimane që pranojnë se ky është gjenocid dhe që do të thonë se nuk duhet të jemi spektatorë të gjenocidit". Ai tha se mbi 500.000 Rohingya janë të bllokuar në Mianmar dhe mund të dëbohen në çdo kohë, duke shtuar se është

koha për të vepruar dhe për të formuar një koalicion. "Apeli im nuk është për njerëzit birmanë. Thirrja ime është për botën islame, si dhe për komunitetet joislame, për të ndihmuar komunitetin Rohingya", theksoi Zarni. "Për shkak se nuk bëhet fjalë vetëm për njerëz muslimanë. Ata janë qenie njerëzore. Por ne, birmanët, në vendin tim i trajtojmë ata më ulët se kafshët", shtoi ai. Më 25 gusht të vitit 2017, Mianmar nisi një dhunë të madhe ushtarake ndaj pakicës etnike muslimane, duke vrarë pothuajse 24.000 civilë, sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Zhvillimit të Ontarios, dhe duke detyruar 750.000 të tjerë, duke përfshirë gratë dhe fëmijët, të iknin në Bangladesh. Rohingya përshkruhen nga OKB si komuniteti më i përndjekur në botë. Dhjetëra muslimanë ishin vrarë edhe në dhunën komunale që shpërtheu në vitin 2012.





Goditja përfundimtare erdhi më 17 shtator, kur forcat sovjetike, bazuar tek një marrëveshjeje sekrete me Gjermaninë, marshuan drejt territorit polak nga Lindja. Varshava u dorëzua më 27 shtator. Dhe më 6 tetor, kapitulloi i gjithë vendi. Polonia pushoi së ekzistuari si një vend. Lufta e Dytë Botërore, sapo kishte filluar

## 1 SHTATOR 1939: PUSHTIMI NAZIST NË SYTË E NJË MJEKU POLAK



# KUR POLONIA PUSHOI SË EKZISTUARI

Në orët e para të mëngjesit të 1 shtatorit 1939, ushtria gjermane filloi një sulm të egër përgjatë kufirit polak. Luftwaffe bombardoi aeroportet, linjat hekurudhore, bazat ushtarake, dhe çdo gjë tjetër që konsiderohej e rëndësishme për komandën dhe lëvizjen e forcave të armatosura polake. Blitzkrieg-u i parë kishte nisur. Një orë më vonë trupat gjermane sulmuan nga veriu dhe jugu, duke synuar rrethimin e ushtrisë polake. Polakët u tërhoqën, ndërsa panë trupat gjermane t'u dilnin pas shpine. Dy ditë më vonë, në shenjë respekti ndaj detyrimeve të tyre ndaj Polonisë, Franca dhe Britanisë i shpallën formalisht luftë Gjermanisë. Por kjo nuk pati asnjë vlerë për Poloninë. Goditja përfundimtare erdhi më 17 shtator, kur forcat sovjetike, bazuar tek një marrëveshjeje sekrete me Gjermaninë, marshuan drejt territorit polak nga Lindja. Varshava u dorëzua më 27 shtator. Dhe më 6 tetor, kapitulloi i gjithë vendi. Polonia pushoi së ekzistuari si një vend. Lufta e Dytë Botërore, sapo kishte filluar.

### DITARI I NJË MJEKU POLAK

Dr. Zigmunt Klukovski, ishte mjeku kryesor i një spitali të vogël

në fshatin Szhebrezhin në jug të qytetit të Lublin. Një diarist entuziast, mjeku kronikoi çdo ditë pushtimin nazist, teksa ngjarjet dramatike shpaloseshin jashtë dritares së dhomës së tij në spital. Zbulimi i vëzhgimeve të tij, do të parathoshte vdekjen e menjëhershme. Prandaj, ai i fshehu me kujdes dorëshkrimet e tij, shpesh duke ndryshuar vendndodhjen e tyre gjatë 5 viteve të pushtimit nazist. Ditari i tij i jashtëzakonshëm u botua në Poloni më 1959, pak para vdekjes së mjekut dhe më pas u përkthye në anglisht.

11 TETOR 1939. Qyteti është i mbushur me gjermanë. Ata janë të akomoduar në të gjitha shtëpitë e mëdha. Shumica e tyre janë nga Austria, dhe disa nga Vjena. Në përgjithësi gjermanët po përipiqen të pastrojnë qytetin. Për këtë punë, përdorin vetëm hebrenjtë. Këta duhet të fshijnë rrugët, të pastrojnë të gjitha çerdhet publike, dhe të mbushin të gjitha gropat nëpër rrugë. Kudo ka njoftime në gjermanisht, që na japin një ide se çfarë mund të presim në të ardhmen. Ne duhet të dorëzojmë të gjitha armët. Duhet të regjistrojmë të gjitha sëmundjet ngjitëse. Mbikëqyrja policore,

është nga ora 10 e mbrëmjes deri në orën 5:30. Kufizimet që vlejné për dyqanet hebraike, ndryshojné nga dita në ditë. Ndonjëherë hebrenjve u lejohet të hapin dyqanet e tyre dhe ndonjëherë jo. Duket se shumica e urdhrave u drejtohen hebrenjve.

18 SHKURT 1940. Takova një grua nga Zamojski. Sapo kishte ardhur nga Çelmo. Për disa kohë, mora disa informacione alarmante për ekzekutimin e të sëmurve mendorë të repartit psikiatrik në Çelmo. E pyeta nëse ajo histori ishte e vërtetë. Ajo më tha se po. Të gjithë të sëmuret mendorë u qëlluan me armë automatike, por nën kërcënimin e dënimit me vdekje, personelit të spitalit i ndalohet të flasë për këtë krim. Është kaq e vështirë të besosh diçka më të tmerrshme sesa sa kjo.

21 TETOR 1942. Sot planifikova të tentoj sërish të shkoj në Zamojski. U zgjova shumë herët për t'u bërë gati, por rreth orës 6 të mëngjesit dëgjova zhurmë, dhe përmes dritares pashë një lëvizje të pazakontë. Ishte fillimi i të ashtuquajturës zhvendosje gjermane të hebrenjve, në realitet një asgjësim i të gjithë popullatës hebraike në Szhebrezhin. Nga mëngjesi i

hershëm deri vonë në mbrëmje, ne përjetuam ngjarje të papërshtueshme, ushtarë të SS të armatosur, xhandarë, dhe "policë në uniforma blu" kaluan nëpër qytet, duke kërkuar hebrenjtë. Ata u grumbulluan tek sheshi i tregut. U morën nga shtëpitë, papafingot dhe vendet e tjera ku ishin fshehur. Të shtëna pistoletash dhe armësh e tjera u dëgjuan gjatë tërë ditës, u hodhën disa herë granata dore nëpër bodrume. Hebrenjtë u rrahën, pa bërë dallime nëse ishin burra, gra apo fëmijë të vegjël. "Në orën 3 të pasdites ishin grumbulluar më shumë se 900 hebrenj. Gjermanët filluan të lëvizin në periferi të qytetit. Të gjithë hebrenjtë do të qëllohen, dhe 400-500 janë vrarë. Polakët u detyruan të fillonin hapjen e varreve në varrezat hebraike. Nga informacionet që morëm, rreth 2000 veta janë fshehur.

Çifutët e arrestuan, u ngarkuan në një tren në stacionin hekurudhor, për t'u zhvendosur në një vend të panjohur. "Ishte një ditë e tmerrshme, nuk mund të përshkruaj gjithçka që ndodhi, as që mund ta imagjinoni barbarizmin e gjermanëve. Jam tërësisht i shokuar, dhe nuk mund ta marr

dot veten. Kemi marrë lajme për plaçkitje që shtohen gjithandej. Në javët e fundit janë shtuar edhe rastet e përdhunimit, ndërsa kam konstatuar shumë shtatzëni. Disa ditë më pare, erdhi për vizitë gruaja e një fermeri të mirënjohur, dhe më vonë një mësuese e re.

22 TETOR 1942. Në qytet, disa nga shtëpitë hebraike u vulosën nga xhandarët, por të tjerët u lanë plotësisht të hapura, ndaj pati shumë grabitje. Është turp të thuhet, por disa polakë morën pjesë në ato krime. Disa njerëz, madje ndihmuan xhandarët të gjejnë hebrenjtë e fshehur. Gjermanët vranë edhe një fëmijë të vogël hebre. Është e vështirë të përshkruhen ngjarje të tilla. Është kaq e tmerrshme, sa që është thuar se pamundur të kuptohet. Ligjërisht në Szhebrezhin nuk ekzistojné më hebrenjtë. Por ende shumë prej tyre, janë duke u fshehur. Herët a vonë, të gjithë do të vriten. Shkova sot në qendrën e qytetit. Numri i përgjithshëm i hebrenjve të vrarë-ata i quajnë me aftësi të kufizuara-është i panjohur, madje edhe specialistët më të mirë u shfarosën. Ne po nisim ta ndjejmë mungesën e mekanikëve të mirë.

(EyewitnessHistory)



# MËMËDHE APO ATDHE?



Nga Faik KONICA

Të parët tanë kanë përdorur gjithmotin fjalën vënt për të thënë dhenë ku u lintmë, ku kemi prindërit edhe varret e stirprindëve, edhe ku flitet gjuha shqipe. Po me kohë, kur zuri të punohet shqipia, gjithë punëtorët e gjuhës kuptuan nevojën të kemi një fjalë, e cila të jetë shqip, si patria, patrie, vaterland, patris, vatan, etj. Në të tjera gjuhëra. Se fjala vënt është e gjërë shumë e munt të meret vesh me shumë mënyra. U zgjuath, pra, fjala mëmëdhe, domethënë dhe ku u lint mëma. Një shkronjëtua i Greqisë vjetër, Pllutarku, ay qi na ka lënë një jetë të Burros (Phyrrhus), thotë që dheu ngaha jemi është më drejt të thohet dheu i nënës se dheu i t'et, pse atje ku kemi nënën, atje na

është lidhur më tepër zëmëra. Shqipëtarët qi krejtin fjalën mëmëdhe, a deshnë t'i përgjigjen mendimit Pllutarkut? S'dihet. Po ky mendim s'na duket i drejt; se, qoftë nga gjuha, qoftë nga mënyrat, qoftë nga gjaku e nga shtypi i fytyrës, njeriu nqaset më tepër t'et e i dhëmp më shumë dheu ku është ku është lindur i ati.

Na duket, pra, se për shqipen, si për gjithë gjuhërat e tjera, fjala atdhe bie më mirë se mëmëdhe.

Përveç kësaj arsëje, është edhe një tjetër me rëndësi të madhe. Një fjalë si kio duhet të jetë një për gjithë shqipëtarët. Fjala mëmëdhe, mjerisht, s'e mbaron këtë nevojë: mëmëdhe gegërisht bie mamdhe; ç'komp është ay komp, ç'gjuh është ajo gjuhë, ku fjala më e nevojshme për të na lidhur bashkë s'është një? Mëmëdhe nuk vetëm s'vete gegërisht, por dhe toskërisht fjala mëmë pakë thohet. Toskët thonë nënë, nëno, e ëmë, po rrallë mëmë. Kio mënyrë fjale përdoret vetëm prej atyre shqiptarëve, qi janë nga rranxa e vlllehve.

Duam të flasim e të shkruajmë një shqipe të qëruar; në e trazofshim me gërqisht, turqisht, italisht e me të tjera gjuhë evgjitesh, më mirë ta lëmë fare shqipen, më mirë të mësojmë ndonjë gjuhë të huaj se ta flasim tonën si ata të zezët e Afrikës, qi silleshin qëmoti nga Arabistani për shërbëtorët në ca shtëpi të mbëdha të Shqipërisë



Përdorimi i fjalës mëmëdhe do t'i sjellë gjuhës aqë mënyra sa ka mënyra folje shqip: mëmëdhe, mamdhe, nënëdhe, nandhe, ëmëdhe, amdhe etj. Fjala atdhe vete në gjithë shqipet. Pastaj, ka edhe një të mirë tjetër: është e shkurtë, e sa të na mundet, të bëjmë fjalë të shkurta, se i përkasin më mirë gjuhës sonë.

Sa për disa të huaj, qi kanë gjak greku e thohen shqiptarë, që të mundin të kllasin në punët e Shqipërisë hundën e tyre (kur kanë një hundë...), të cilët zakonojnë të shkruajnë patridjë, do t'u thomi se s'dinë miaft shqip për të kallur fjalë të ra te gjuha jonë.

Duam të flasim e të shkruajmë një shqipe të qëruar; në e trazofshim me gërqisht, turqisht, italisht e me të tjera gjuhë evgjitesh, më mirë ta lëmë fare shqipen, më mirë të mësojmë ndonjë gjuhë të huaj se ta flasim tonën si ata të zezët e Afrikës, qi silleshin qëmoti nga Arabistani për shërbëtorët në ca shtëpi të mbëdha të Shqipërisë. (Albania, 1899)

## Sekretet e aktrimit

të të tjerëve. Ajo asnjëherë nuk iu dorëzua shfrytëzimit vulgar, sikurse kanë bërë disa të ashtuquajtura "metoda" të njohura të aktrimit. Si rrjedhojë, kontributet e saj ndaj kulturës teatrore kanë mbetur në masë të madhe të panjohura, të papranuara dhe të pavlerësuara", thotë ai. Sipas Brandon, ajo qe e vetmja nga artistët amerikanë, që shkoi në Paris për të studiuar me Konstantin Stanislavskin, i cili vetë qe një vëzhgues mjeshtëror i sjelljes njerëzore dhe figura më e spikatur në teatrin rus. Ajo solli në këtë vend një dituri të teknikës së tij dhe ia bashkangjiti mësimdhë-

nies së saj. Ajo nuk e mendonte, se mësimet e saj do të kishin ndikim në kulturën teatrale anëmbanë botës. Pothuajse e gjithë filmografia kudo në botë është prekur nga filmat amerikanë, e cila, si pasojë, është ndikuar nga mësimet e Stella Adlerit. Janë të shumtë njerëzit, që e kanë dashur atë, dhe ne i detyrohemi shumë asaj.

"U jam mirënjohës kontributeve të paçmuara, që ajo i ka dhënë jetës sime dhe ndihem i privilegjuar, që kam qenë pjesë e shoqërisë dhe e familjes së saj, profesionalisht dhe personalisht gjatë gjithë jetës sime", thotë Brandon.



## Librat e Enver Hoxhës në librarinë e Buenos Aires

Përkthyesi i njohur i spanjishtes Bajram Karapollit teksta tregon se këto ditë do të dalë në shitje romani i tretë dhe i fundit i Ernesto Sabatos, "Abadoni, engjëlli i skëterrës", tregon një episod mbi udhëtimin e tij kohë me parë në Buenos Aires ku në një librari është hasur me veprat e

Enver Hoxhës. "Ishte aty nga mesi i dhjetorit të vitit 2000. Po ecja përgjatë Avenidës 'Corrientes', në Buenos Aires, në kërkim të ndonjë bukinisti, për të blerë romanet e Ernesto Sabatos. Dihet se në këto lloj librarish të vjetra mund të gesh libra të çmueshëm me çmim tejet të arsyeshëm. Hyra në një të tillë dhe po këqyrja librat në rafte. Për çudi vështrimi im kapi shpinën e disa të ashtuquajturave vepra të Enver Hoxhës: 'Me Stalinin' dhe 'Rreziku angloamerikan për Shqipërinë'. Natyrisht në spanjisht. Për të shuar kureshtjen pyes pronarin, një burrë i moshuar, se si kishin mbërritur ato libra në librarinë e tij. Ka 15 apo 20 vjet, më thotë, m'i sollën nja dy persona, mbase të ambasadës së Shqipërisë. Kur u thashë se nuk më duheshin, më thanë se nuk do të m'i shisnin, përkundrazi, do të më paguanin për to. Natyrisht, pranova. Më thanë t'i vendosja në vitrinë se donin t'i fotografonin. I fotografuan, më paguan dhe ikën. Pastaj unë i vendosa në raft dhe ja ku janë. Paradoksi: të gesh në Argjentinë librat e diktatorit të Shqipërisë të përkthyer në spanjisht, ndërkohë që shkrimtarë argjentinas si Borges, Sabato, Arlt, Cortazar, etj, gjigantë të letërsisë botërore të mos ua kesh dëgjuar as emrin e jo më t'i kesh lexuar në shqip. Dhe kini parasysh ato çka thotë për Shqipërinë Sabato në romanin e tij të fundit. A nuk është për të vënë duart në kokë?! Vetëm barbaria komuniste mund të bënte gjëma të tilla që, gjatë gjysmë shekulli, të ndalonte autorë të tillë e aq më tepër libra të tillë, ku lexuesi shqiptar do të gjente fragmente me lëndë dhe hyznizime për atdheun e tij" shkruan Karapollit.



Marlon Brando e quan Stella Adler autoren e librit të njohur për aktrimin, një mjeshtre për të zbuluar të fshehtat e aktorit. "Për mua, Stella Adler është shumë më tepër

se një mësuese aktrimit. Përmes punës së saj ajo përçon llojin më të vyer të informacionit - si të zbulojmë natyrën e mekanizmave tanë emocionalë dhe prej këtej ato

Koha, e enjte, 6 shtator 2018

# KOSOVA, NJË BEBE QË PO RRITET

“Kosova është një bebe. Është vetëm dyvjeçare. Ka shpresa për t’u rritur dhe për t’u zhvilluar. Duhet të rrimë të qetë, duhet të bëjmë çmos për të fituar, por duhet të jemi të qetë dhe të kujdesshëm. Kosova ka të ardhme. Mua më duhet të rri shumë i qetë. Për një shans për kualifikim në Evropian ose në Botëror duhet të përgatitemi për disa vite. Kjo nuk bëhet për një ditë, për një javë ose për një muaj”, deklaroi Challandes



Përfaqësuesja e Kosovës ka të ardhme të ndritshme, por momentalisht është ende “e vogël” për të synuar diçka të madhe. Kështu mendon përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës, Bernard Challandes, i cili thotë se po mundohet ta ndërtojë një ekip solid, i cili do të mundë të arrinte suksese në të ardhmen, shkruan gazeta “Zëri”. Verdhelaltrit morën pjesë për herë të parë në kualifikimet e “Botërorit 2018” pas pranimit të Kosovës në UEFA e në FIFA më shumë se dy vjet më parë. Euforia ishte e madhe, mbi të gjitha pas barazimit me Finlandën në udhëtim, por më pas pasuan nëntë humbje të cilat i zbritën “Dardanët” me këmbët në tokë. Edhe tash ekzi-

ston një optimizëm i madh në vend për Ligën e Kombeve, por trajneri zviceran i ka qetësuar prapë kosovarët duke ua përkujtuar atyre se ky është vetëm fillimi. Sipas tij, nevojitet një periudhë pak më e gjatë për të synuar kualifikim në kompeticionet më të mëdha të futbollit për përfaqësues. Sidoqoftë, ai është i bindur se ekipi i tij po shkon në rrugën e duhur për ta bërë këtë arritje historike.

“Kosova është një bebe. Është vetëm dyvjeçare. Ka shpresa për t’u rritur dhe për t’u zhvilluar. Duhet të rrimë të qetë, duhet të bëjmë çmos për të fituar, por duhet të jemi të qetë dhe të kujdesshëm. Kosova ka të ardhme. Mua më duhet të rri shumë i qetë.

Për një shans për kualifikim në Evropian ose në Botëror duhet të përgatitemi për disa vite. Kjo nuk bëhet për një ditë, për një javë ose për një muaj”, deklaroi Challandes. Trajneri zviceran këshillon lojtarët e tij t’i harrojnë paraqitjet dhe rezultatet e mira në miqësoret e fundit dhe të përqendrohen në ndeshjet zyrtare që i kanë përpara tyre.

“Deri më tash kemi pasur rezultate mjaft të mira dhe kemi bërë lojërë të mira. Duhet të mësohemi me suksese dhe me fitore. Këto fitore janë të mira, por edhe të rrezikshme, sidomos për Kosovën në Ligën e Kombeve. Nëse mendojmë që jemi favoritë, do të gabohemi”, ka shtuar ai. Ai ka kërkuar respekt ndaj kundërsh-

tarëve dhe nuk mendon se Kosova është favorite në këto duela. “Kundërshtarët tanë Malta, Azerbajxhani e Ishujt Faro nuk janë Kroacia, Anglia ose Belgjika, por asnjë ekip i madh nuk ka arritur t’i mposhtë Ishujt Faro 6:0 për shembull. Edhe Azerbajxhani është ekipi më mirë i klasifikuar në listën e FIFA-s”, përkujton ai. “Ne nuk duhet të mendojmë që jemi shumë të fortë dhe që mund të fitojmë lehtë pasi e kemi mundur Shqipërinë. Duhet të jemi të kujdesshëm”, përfundoi Challandes, i cili shprehet i brengosur sa i përket mbrojtjes, pasi pjesa dërrmuese e lojtarëve të kësaj pozite nuk po luajnë në ekipet e tyre dhe po kanë vështirësi.

## Azerbajxhani-Kosova, bie kuota e “Dardanëve”

Disa ditë më parë Azerbajxhani ishte dukshëm favorit kundër Kosovës, por kuotat kanë lëvizur dukshëm në orët e fundit. “Bet365”, një ndër bastoret sportive më të mëdha në botë, ditë më parë kishte kuotuar 4.60 një fitore të mundshme të Kosovës në udhëtim, ndërsa ajo ka zbritur në 4.00, teksa nga 1.85 për fitoren e Azerbajxhanit, kuota ka shkuar mbi 2. Pothuajse në gjitha bastoret më të mëdha të botës është duke rënë kuota Kosovës, kur Azer-

bajxhanit vazhdon t’i ngritët sinjale se kjo ndeshje mund të jetë e paparashikueshme. “Nations League”, turneu më i ri ndërkombëtar për përfaqësueset evropiane do të nisë këtë javë. Kosova është në grupin D3 me Azerbajxhanin, Malten dhe Ishujt Faro. Ndeshjen e parë Kosova e luan në udhëtim te Azerbajxhani me 7 shtator, e cila zhvillohet nga ora 18:00, kurse ndeshjen e dytë e zhvillon në shtëpi, në stadiumin “Fadil Vokrri” të hënën me 10 shtator.

## Fabiana Bytyqi do të luftojë për titull bote



Boksierja kosovare Fabiana Bytyqi do të ketë rastin e saj për të fituar një titull të madh të botës në boks profesionist. Fabiana, që jeton dhe zhvillon karrierën në Çeki, do të ndeshet më 22 shtator në Ustinad Labem të Çekisë me britaniken Denise Castle për titullin WBC në kategorinë atom (46.27 kilogramë). Për 22-vjeçaren do të jetë lufta e 14-të në boks profesionist, ndërsa i ka fituar 13 meçet e deritashme, prej tyre pesë me nokaut. Ajo gjatë kar-

rierës ka fituar titull të botës për të reja në versionin WBC dhe po ashtu titullin WBC Silver. Kundërshtarja e Bytyqit është britanikja 46-vjeçare Denise Castle, që ka vetëm tri meçet në boks profesionist. Ajo ka fituar dy meçet e para dhe të fundit e zhvilloi shumë kohë më parë, më 2 gusht të vitit 2014, kur ishte mposhtur për titull bote në kategorinë atom në versionin WBC nga japonezja Momo Koseki me nokaut teknik në raundin e tetë.

## Rezervisti i Gjilanit udhëton për t’u përballur me Argjentinën

Dy reprezentues ka dhënë Superliga e Kosovës në futboll për ndeshjet e këtij muaji të përfaqësueseve. Njëri është Visar Bekaj, portieri i Prishtinës që është i vetmi nga Superliga i ftuar në përfaqësues të Kosovës. Tjetri është Wilber Perez, sulmuesi që më 10 gusht iu bashkua Gjilanit. Perez 29-vjeçar është ftuar nga përfaqësuesja e Guatemalës për ndeshjet miqësore me Argjentinën dhe Ekuadorin. Ndonëse Perez te Gjilani është vetëm rezervist, ai pritet që më 8 shtator në Los Angeles të SHBA-së të jetë në fushë përballë yjeve të Argjentinës. Te Argjentina nuk është grumbulluar Lionel Messi, por kjo përfaqësues ka lojtarë të tjerë të mëdhenj si për shembull Paulo Dybala e Mauro Icardin. Perez është një prej tre legjionarëve në përfaqësuesen e Guatemalës. Një lojtar i kësaj përfaqësues luan në SHBA e një në Kolumbi. Të tjerët janë pjesë e kampionatit vendor.



## Shqipëri-Izrael sfidë me rëndësi të madhe për UEFA-n, gjykon arbitri i finales së Championsit!

Një hungarez për Shqipëri Izrael. Sfidat e 7 shtatorit në Elbasan do të drejtohet nga arbitri i mirënjohur Viktor Kassai. 42-vjeçari nga Tata-banya është një gjyqtar shumë i njohur në arenën ndërkombëtare. Në vitin 2011 UEFA vendosi që Kassai të gjykonte finalen e Champions League mes Barcelonës dhe Manchester United, ndërsa ka qenë pjesë edhe e Botërorit të vitit 2010 dhe Europeanit të vitit 2012. Vitin e kaluar në Champions League, hungarezi irritoi tejmase futbollistët dhe tifozët e Bayern Munich me vendimet e tij në sfidën e kthimit gjysmëfinale të Champions League dhe me atë paraqitje të dobët humbi pikë të rëndësishme në sytë e UEFA-s. Për të ruajtur standartin e lartë të arbitrimin dhe për t’iu rikthyer niveleve më të larta UEFA i ka caktuar Kassai gjykimin e sfidës shumë delikate të Ligës së Kombeve mes Shqipërisë dhe Izraelit.





## Luis e deshi transferimin te PSG-ja

Mbrojtësi i Atletico Madridit, Felipe Luis e pranon se deshi të diskutonte për një lëvizje drejt Paris Saint-Germainit gjatë verës, por klubi bëri që ai të kishte një imazh të keq. Repreruesi brazilian ishte njëri prej lojtarëve që klubi parisien kërkoi gjatë afatit kalimtar të verës për të zgjidhur problemet në krahun e majtë të mbrojtjes, para se ata në fund të nënshkruanin me Juan Bernatin nga Bayern Munich. Sidoqoftë, ish-futbollisti i Chelsea mbeti i frustruar që nuk ishte në gjendje që së paku të diskutonte për një marrëveshje me klubin francez. "Ishte një shans që të shkoja te PSG-ja. Unë fola me Atletico dhe kërkova nga ata që të ma lejonin largimin, ashtu siç e kishin lëshuar Gabin së fundmi. Klub tha se nuk është situata e njëjtë, pavarësisht ngjashmërive të periudhës së mbetur në kontratat tona", deklaroi Luis. "Ata thanë se unë desha t'i detyroja për një lëvizje, por është gënjeshtër. Unë kam një histori me Atletico dhe kjo më pikëlloi. Ata u munduan që të më bëjnë imazh të keq në klub", shtoi ai.



## Mavraj transferohet në Greqi

Pas disa muajsh të vështirë në aspektin sportiv, e ardhmja e Mërgim Mavrajt në futboll është vendosur tashmë dhe do të jetë në Selanik. Qendëmbrojtësi i kombëtares kuqezi ka nënshkruar një kontratë dy vjeçare me skuadrën e Arisit, ku vetëm disa ditë më parë u transferua edhe Migjen Basha. Lajmi për arritjen e marrëveshjes u konfirmua për mediat greke nga presidenti i Arisit të Selanikut Theodor Karipidis, i cili në profilin e tij zyrtar ka hedhur një foto të Mavrajt me fanellën e klubit grek. Aktualisht Mërgim Mavraj është angazhuar me Kombëtaren shqiptare, në pritje të ndeshjeve të Ligës së Kombeve ndaj Izraelit dhe Skocisë, ndërsa më pas do t'i bashkohet klubit të Selanikut.

## US OPEN 2018

# ELIMINOHET STEPHENS, KALON NADAL

Në kampin e meshkujve, Rafael Nadal dhe Dominic Thiem u bënë protagonistë të një ndeshjeje epike që zgjati 4 orë e 49 minuta ku fitues në fund doli pikërisht tenisti spanjoll 3-2

Surpriza e radhës së US Open e ka emrin Sloan Stephens. Kampionia në fuqi e turneut u eliminua në fazën çerekfinale pasi u mposht nga Sevastova, numri 19 i renditjes botërore. Tenista letoneze u shfaq superiore ndaj Stephens ndeshjen me të cilën e fitoi 2-0 pas 1 orë e 24 minutave lojë me sete 6-2; 6-3. në gjysmëfinale Sevastova do të përballlet me një tjetër amerikane, Serena Williams.

Kjo e fundit eliminoi në çerekfinale Karolina Pliskova teksa e mundi atë me rezultatin 2-0. 6-4; 6-3 ishte rezultati i seteve të fituara nga Serena Williams e cila e sheh veten vetëm 2 ndeshje larg



titullit të saj të parë Grand Slam në statusin e nënës. Në kampin e meshkujve, Rafael Nadal dhe Dominic Thiem u bënë protagonistë të një ndeshjeje epike që zgjati 4 orë e 49 minuta ku fitues në fund doli pikërisht tenisti spanjoll 3-2. Fillimi i sfidës ishte katastrofik

për Nadal që humbi setin e parë 0-6, por numri 1 i botës reagoi dhe përmbysi situatën duke marrë kryesimin në 2-1 pasi fitoi setin e dytë e të 3 6-4; 7-5. Thiem iu kundërpërgjigj në të kartën që e fitoi me tiebreak 7-6. Tiebreaku zgjidhi edhe setin final që shkoi

për Nadal i cili në gjysmëfinale do të luajë me Juan Martin del Potro. Argjentinasi mundi amerikanin John Isner për të qenë mes 4 më të mirëve të turneut. 3-1 ishte rezultati me të cilin Del Potro e fitoi këtë ndeshje me sete 6-7; 6-3; 7-6; 6-2.

## Suarezi e mirëpret Pogban te Barça



Luis Suarez ka thënë se ylli i Manchester Unitedit, Paul Pogba do të ishte i mirëseardhur te Barcelona. Mediat kanë raportuar se Unitedi refuzoi një ofertë të Barçës prej 50 milionë eurove dhe një lojtar, derisa mbrojtësi Gerard Pique hapur ka folur për transferimin e mundshëm të francezit.

"Paul Pogba është lojtar elitare që ka fituar gjithçka", ka thënë Suarez për radion RAC1. "Është lojtar me shumë kualitet dhe njëri prej yjeve të Manchester Unitedit dhe do të garantojë për më shumë trofe sesa tani. Është i mirëseardhur te Barcelona edhe nëse nuk është lojtar i ynë".

## Guardiola u ndalon celularët lojtarëve!



Barazimi me Wolverhampton akoma nuk i ka ikur nga mendja Pep Guardiolas, i cili me Manchester Cityn e tij gjendet 2 pikë larg kreut të klasifikimit, që përbëhet nga treshja Liverpool, Chelsea e surpriza Watford. Pep njihet si një tranjer "i hekurt" për sa i përket rregullave, e në çdo klub ku ka shkuar, ka qenë shumë i rreptë me disiplinën. Në ekipet që ka trajnuar në të kaluarën, ai madje pati vënë rregulla edhe për sa i përket ushqimeve e pijeve, apo edhe pamjes së tepruar. Këtë herë, në shënjestrën e katalanasit, janë vënë celularët e lojtarëve, të cilët ndalohen rreptësisht në fushën e

stërvitjes. Përveç se në Premier League, Guardiola kërkon të konfirmohet dhe në Champions, ku në fazën e grupeve do të përballlet me Lyon, Hoffenheim dhe Shakhtar Donetsk. Gjithashtu do të ketë gjoba për vonesat në stërvitje, e këtë e vuajti i pari Benjamin Mendy. Një tjetër lojtar që ka vuajtur ka qenë dhe Leroy Sané, i cili u përjashtua nga ndeshja me Newcastle, për shkak të angazhimit të pakët në stërvitje. Guardiola kërkon të dërgojë një mesazh të qartë për lojtarët e tij, duke mos kursyer askënd. E duke parë 24 titujt në CV e tij, mbase duhet ti jepet të drejtë.

## Nga shkolla në fushë, 15-vjeçari që mahniti Anglinë

Luke Matheson është futbollisti më i ri nga i cili kanë hedhur sytë skuadrat më në zë të Premier League. Luke është vetëm 15 vjeç dhe paraditen e së martës, ai ishte në shkollë si të gjithë bashkëmoshatarët e tij, por mbase ditë ëndrra u bë realitet. Talenti i Rochdale u befusua kur trajneri i tha që është pjesë e ekipit në ndeshjen ndaj Buryt. Megjithatë nuk u mbyll këtu. Vetëm 13 minuta në stol dhe një dëmtim i

Randall bëri që 15-vjeçari të debutonte në futbollin profesionist. Ai nuk zhgënjeu, madje shkëlqeu, duke u shpallur lojtari i ndeshjes në fundin e takimit. Disa nga lojtarët në fushën e lojës ndoshta ishin në moshën e baba-it të tij, por në fund ishte Luke që shkëlqeu. Manchester United e Chelsea janë vënë në gjurmët e talentit dhe tashmë synojnë ta "rrembejnë" atë sa më parë.



# “AMBASADORËT SHQIPTARË TË SPORTIT”, ZBULOHEN TË NOMINUARIT

Shpallen nominimet për çmimet “Ambasadorët Shqiptarë të Sportit”, një iniciativë kjo e re për të promovuar imazhin e Shqipërisë përmes sportit. Ky event ndërrohet për herë të parë sportistët dhe trajnerët shqiptarë për performancën jashtë Shqipërisë. Presidenti i shoqatës “Ambasadori i Futbollit Gjerman”, Roland Bischof, mori fjalën në konferencë si iniciuesi i kësaj nisme, duke theksuar se ky event do të mbështesë të gjithë sportistët jashtë Shqipërisë, që e meritojnë dhe kanë përçar vlera. Kryetari i juri-së, presidenti i FSHF-së, Armand Duka, zbuloi të nominuarit për Çmimin kryesor.

Ata janë: Lorik Cana, Edvin Murati dhe Igli Tare (të tre futbollistë).

Për Çmimin e Nderit u nominuan: Ansi Agoll (futbollist), Elizabeta Karaboli (qitëse) dhe Majlinda Kelmendi (xhudiste).

Të nominuar për çmimin e të



rinjve janë vojebollistja Erblira Bici, atleti Izmir Smajlaj dhe portieri Thomas Strakosha.

Konkurrojnë për Çmimin e Publikut: Eerald Dervishi, Haki Doku, Elseid Hysaj, Luiza Gega, Luan Krasniqi dhe Ervin Skela.

Fituesit e çmimeve “Ambasadorët Shqiptarë të Sportit” do të

shpallen në një mbrëmje gala, më 28 shtator, në Pallatin e Brigadave. Në juri janë emra të njohur si ish-trajneri i Kombëtares Gianni de Biasi, gazetari Dritan Shakohoxha apo trajnerja e basketbollit, Mirza Alibegaj.

Çmimi Kryesor: Lorik Cana, Edvin Murati, Igli Tare.

Çmimi i Nderit: Ansi Agoll, Elizabeta Karaboli, Majlinda Kelmendi.

Çmimi “New Entry”: Erblira Bici, Izmir Smajlaj, Thomas Strakosha.

Çmimi i Publikut: Eerald Dervishi, Haki Doka, Elseid Hysaj, Luiza Gega, Luan Krasniqi, Ervin Skela.



## Bunjaki konfirmon bisedimet me skuadrën turke

Ish-seleksionuesi i Kosovës, Albert Bunjaki, mund të emërohet trajner i skuadrës elitare të Turqisë, Rizespor. Bisedimet me skuadrën e Superligës turke i ka konfirmuar të martën trajneri Bunjaki. Bunjaki mund ta zëvendësojë trajnerin e larguar Ibrahim Uzunmez. Bunjaki ka thënë se menaxheri i tij turk është në bisedime të rregullta këto ditë me drejtuesit e klubit që nuk nisi mirë edicionin. Bunjaki është pa angazhim në futboll që nga 9 tetori i vitit të kaluar kur la postin e përzgjedhësit të Kosovës. Ai kishte drejtuar Kosovën prej vitit 2009 dhe i adresohen merita të mëdha për vënie të themelit të përfaqësueses e po ashtu për afrimin e shumë lojtarëve. Në kualifikimet e para të saj, ato për botërorin “Rusia 2018”, Kosova drejtuar nga Bunjaki pati një barazim e nëntë humbje. Dhe ky bilanc bëri që me marrëveshje të dyanshme të ndërpritet bashkëpunimi i FFK-së me Bunjakin.

## Mancini fikson formacionin, Italia me skemën 4-3-3

Me skemën 4-3-3 kështu do të debutojë Roberto Mancini në një ndeshje zyrtare me Italinë. Ish trajneri i Interit ka fiksuar formacionin për sfidën e parë në Ligën e Kombeve atë ndaj Polonisë së Robert Lewandowskit. Në portë i përzgjedhuri i Mancinit është gjiganti i Milanit Giggio Donnarumma, mbrojtja do të përbëhet nga Zappacosta dhe 3 futbollistë ek-

spertë, Bonucci e Chiellini në qendër dhe Criscito në të majtë. Diga para mbrojtjes në mesfushë do të jetë Gagliardini i Interit ndërsa përkrah tij do të rreshtohen Jorginho e Pellegrini, ndërkohë që trashja e sulmit do të përbëhet nga Bernardeschi, Balotelli e Insigne, të paktën kështu raporton Gazzetta Dello Sport.



## Low zgjedh pasuesin e Ozil

Pikërisht për të marrë me vete në Brazil, Julian Brandt, trajneri i Gjermanisë Joachim Low la jashtë Kupës së Botës një talent të padiskutueshëm si Leroy Sane, ndërsa tashmë për të shfaqur edhe njëherë besimin që ka për yllin e ri të Bayer Leverkusen, numri 1 i stolit të pancerave ka vendosur që të jetë Julian Brandt ai që do të mbajë mbi shpatulla fanellën me

numër 10 të Gjermanisë, për të pasuar kështu të tërhequr Mesut Ozil. Brandt kërkon t’ia shpërblejë besimin trajnerit të tij. Kur pyetet për rëndësinë që ka për të fanella legjendare, 22-vjeçari shprehet: “Numri 10 ka një rëndësi të madhe në futboll, ashtu si në kombëtaren gjermane. Do të mundohem të jap më të mirën time”.



## Kërkon të largohet nga Manchester United

Futbollisti spanjoll, Ander Herrera, është i gatshëm t’i vlerësojë ofertat për largim nga Manchester Unitedi gjatë afatit kalimtar të janarit pasi klubi është vonuar për t’i ofruar kontratë të re. Mesfushori spanjoll së fundmi kishte bërë të qartë se dëshiron të mbetet në “Old Trafford”. Por, ai ka mbetur i dëshpëruar nga hezitimi i klubit për të konfirmuar të ardhmen e tij. Andaj, Herrera ka vendosur ta konsiderojë interesimin e klubeve të tjera në janar, për ta shqyrtuar mundësinë e largimit nga Manchester Unitedi.



## Atletja kroate e bën shqiponjën dykrerëshe pasi e fiton garën

Atletja kroate Sandra Perkovic i është gëzuar triumfit në një garë ndërkombëtare të atletikës në Kroaci, duke e bërë me duar simbolin e shqiponjën dykrerëshe. Perkovic fitoi bindshëm në hedhje të diskut, të cilin e flaki 67.60 metra larg, duke e lënë në vendin e dytë kubanen Yaime Perez dhe në vendin e tretë amerikanen Valerie Allman. Por, festimi i saj - i ngjashëm me atë të futbollistëve shqiptarë të Zvicrës, Granit Xhakës dhe Xherdan Shaqirit - mori vëmendjen saqë pas triumfit Perko-

vic u pyet nëse i kishte imituar ata. Xhaka dhe Shaqiri shkaktuan polemika të mëdha në Kupën e Botës këtë verë në Rusi, kur golat e shënuara në fitoren e Zvicrës ndaj Serbisë, i festuan duke e bërë shqiponjën. Si pasojë, ata u gjobiten nga FIFA dhe morën paralajmërim me mos ta përsërisin më. Ndërkohë, Sandra, pasi e fitoi garën dhe e bëri shqiponjën, u pyet rreth festimit nga gazetari i HTV. “Festimi im pati kuptimin se më në fund disku fluturoi”, shpjegoi Sandra.




# MERITOJ TË JEM NË TOP TRESHEN PËR TOPIN E ARTË

Ylli francez i Atletico Madridit, Antoine Griezmann, beson se ai ka qenë një nga tre lojtarët më të mirë në botë gjatë vitit 2018, dhe për këtë arsye mendon se ai e meriton të jetë një nga tre lojtarët e emëruar për ta fituar çmimin "Topi i artë". Pasi ishte emëruar në treshen më të mirë për këtë çmim në vitin 2016, 27-vjeçari beson se ai e meriton që të paktën të ketë të njëjtën arritje, nëse jo të ngritët në pozitë. Atë vit ai përfundoi në pozitën e tretë, pas Cristiano Ronaldos dhe Lionel Messit, përcjell Gazeta Express.

Sulmuesi i Atletico Madridit pati një verë mjaft të suksesshme. Ai ishte një ndër lojtarët më të rëndësishëm në rrugëtimin e Kombëtares së Francë drejt triumfit në turneun e Kupës së Botës në Rusi. Griezmann ishte votuar si lojtari i tretë më i mirë në këtë turne, pas Luka Modriçit dhe Eden Hazardit. Dhe tani, ai beson se e meriton të shpërblehet për suksesin e tij gjatë sezonit të kaluar, gjatë të cilit ai shënoi 23 gola në 33 paraqitje për Atletico Ma-

**"Është e çuditshme. Kjo është një trofe që jepet nga FIFA, apo jo? Ne e fituam titullin e Kupës së Botës në Rusi dhe nuk ka asnjë francez në këtë listë. Kjo është zgjedhja e tyre, por është e çuditshme"**



dridin, duke i ndihmuar atyre të fitojnë titullin e Evropa Ligës dhe Superkupës së Evropës. "E meritoj të jem në top treshen. Në vitin 2016, unë i humba dy finale, ndërsa këtë vit unë i fitova tri tituj, kështu që normalisht...", ka thënë Griezmann. Gjithashtu, Griezmanni e ka pranuar se ai është habitur që as ai dhe asnjë nga bashkëlojtarët e tij francez nuk

është nominuar për çmimin e FIFA-s për lojtarin më të mirë. Në këtë listë janë emëruar Luka Modriç, Cristiano Ronaldo dhe Mohamed Salah.

"Është e çuditshme. Kjo është një trofe që jepet nga FIFA, apo jo? Ne e fituam titullin e Kupës së Botës në Rusi dhe nuk ka asnjë francez në këtë listë. Kjo është zgjedhja e tyre, por është e çudit-

shme". Madje, Griezmanni bërë shaka edhe bashkëlojtarin e tij në Francë, Kylian Mbappe, i cili nuk e zgjodhi yllin e Atletico si një ndër favoritët e tij për të fituar çmimin "Topi i Artë", pas turneut të Kupës së Botës. "Ndoshta ka harruar!? Duhet ta pyesni përsëri. Ose ndoshta edhe nuk i pëlqen futbollimi? Të gjithë kanë mendimet e tyre".

## Messi meriton më shumë tituj të Ligës së Kampionëve



Ylli i Barcelonës, Luis Suarez, beson se partneri i tij në sulm, Lionel Messi, meriton më shumë tituj se që ka në Ligën e Kampionëve. Barcelona është e vendosur ta fitojë edhe një titull tjetër në Ligën e Kampionëve këtë sezon, pasi ka qenë dëshmitare e triumfit të rivalit të vet, Real Madridit, në tri sezonet e fundit rresht në këtë garë prestigjioze evropiane. Por, sulmuesi uruguaiian beson se Messi është dashur të fitonte më

shumë se katër medalje në Ligën e Kampionëve. "Liga e Kampionëve është garë që të karakterizon, sepse lojtarët dhe ekipet më të mira të Evropës luajnë aty", tha Suarez. "Natyrisht se të zemëron kur rivali yt i fiton tre tituj radhazi në Ligën e Kampionëve, sepse është historike. Kjo na e shton dëshirën për t'i ndryshuar gjërat plotësisht. Messi, si lojtar, meriton më shumë tituj se që ka në Ligën e Kampionëve", tha ai.

## Ronaldo fiton më shumë se të gjithë lojtarët e 10 klubeve në Serie A

Pas tri ndeshjeve të kampionatit, Ronaldo nuk arriti të regjistrohet në listën e golashënuesve ndërsa mediat italiane tashmë kanë ngritur pyetjen për të ardhurat e tij dhe sa kjo është e justifikueshme

Një nga lojtarët më të mirë të botës Cristiano Ronaldo në Juventus merr të ardhura vjetore, shumë e cila është më të lartë se vlera e përgjithshme të cilat 10 klubet e Serie A së bashku ndajnë në vit për të paguar të gjithë lojtarët. Pas disa sezoneve të suksesshme në Real Madrid, portugezi Ronaldo këtë verë për një kompensim prej 100 milionë eurosh kaloi në radhët e Juventusit. Mediat italiane dhe ato botë-

rore lidhur me këtë transfer shkruanin si për përforcimin më të madh të klubit nga Torino dhe në përgjithësi në Serie A. Pas tri ndeshjeve të kampionatit, Ronaldo nuk arriti të regjistrohet në listën e golashënuesve ndërsa mediat italiane tashmë kanë ngritur pyetjen për të ardhurat e tij dhe sa kjo është e justifikueshme. Ronaldo me pagën vjetore prej 31 milionë euro është larg lojtari më i paguar në Itali. Mediat gjithash-



tu shkruajnë se Ronaldo në Juventus ka pagën më të lartë vjetore se të gjithë lojtarët së bashku që luajnë në Atalanta, Chievo, Empoli, Frosinone, Genoa, Parma, Sassuolo, Spal dhe Udinese. Vitin e kaluar argjenti-

nasi Gonzalo Higuain si lojtari më i paguar në Itali, përfitonte 7,5 milionë euro. Me kalimin e tij në Milano, paga e tij vjetore shkoi në 9,5 milionë euro, por kjo nuk është as një e treta e pagës që merr Ronaldo.



## Ish-kampionia e notit emërohet ministre e Sportit

Ish-kampionia e notit, Roxana Maracineanu, është emëruar ministre e Sportit në Francë, në vend të ministres së larguar, Laura Flessel. Maracineanu, 43 vjeçe, është vajza e refugjatëve politikë rumunë në Francë. Maracineanu ishte kampione e botës në not në 200 metra në Botërorin e vitit 1998 në Perth, Australi. Maracineanu ka edhe eksperiencë politike, në veçanti ajo e këshilltares së rajonit të Ile-de-France, në Paris. Korrikun e kaluar, kryeministri Edouard Philippe i kishte bërë një kërkesë për të ndjekur një mision të Ministrisë së Arsimit për të luftuar kundër mbytjeve të shumta të turistëve në det dhe në pishina. Roxana, vajzë e refugjatëve rumunë, është cituar, ndër të tjera, si shembull i integritit.



## Pogba dëshiron të luajë për Zidanin

Paul Pogba e ka ëndërr të luajë nën urdhrat e njërit prej heronjve të fëmijërisë së tij. Ylli i Manchester Unitedit, Paul Pogba, po ëndërron që një ditë ta ketë për trajner Zinedine Zidanin, sipas tabloidit britanik "The Sun". Pasi u largua nga Real Madridi këtë verë, është përfolur se Zidane mund ta marrë drejtimin e Manchester Unitedit, me Jose Mourinho nën presion të madh pas rezultateve të dobëta. Pogba do ta shfrytëzonte rastin për të punuar me Zidanin, të cilin e ka adhuruar si fëmijë.

Koha, e enjte, 6 shtator 2018

**DASHI** 21. mars - 20. prill

Kjo ditë do të jetë mjaft e ngarkuar dhe do ju lejojë që të merrni rezultate të rëndësishme për karrierën tuaj. Ndiqni gjithmonë instinktin dhe mos u bllokoni nga kritikak e të tjerëve. Në dashuri parashikohen përgjigje të rëndësishme, të cilat do ju bëjnë më euforik dhe pozitiv.

**DEMI** 21. prill - 21. maj

Mundohuni që të fokusoni më mirë energjitë tuaja në çështje të cilat i konsideroni vërtetë të rëndësishme, pasi në këtë moment nuk mund të rrezikoni të hidhni ndonjë hap të gabuar. Kjo e mërkurë do ju gjejë më të komunikueshëm. Pritet të merrni kënaqësi.

**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Merrni pak më shumë kohë për të menduar për veten dhe mirëqenien tuaj. Kjo gjë do ju shërbejë jo vetëm për tu karikuar me energji, por edhe për të reflektuar me më shumë vëmendje lidhur me disa çështje që në të kaluarën i keni lënë pezull. Në dashuri dhe në familje, këshillohet të mos jeni shumë agresiv.

**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Hapet një fazë e rëndësishme për të marrë përgjigje të cilat i prisnit prej kohësh. Mos jini nervoz, pasi të gjitha ndryshimet me të cilat po përballeni do ju lejojnë që të gjeni sigurinë në veten tuaj.

**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Duhet të mundoheni të mos lini pas dore sinjalet që po ju dërgon trupi, sidomos nëse së fundmi nuk keni pushuar mjaftueshëm. Një takim special do ju bëjë nervoz, por mos merrni vendime të nxituara sa i takon sferës së ndjenjave.

**VIRJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Duhet të mundoheni që të limitoni shpenzimet tuaja, sidomos nëse gjatë javëve të fundit keni bërë investime të rëndësishme për karrierën tuaj. Për shkak të natyrës që keni, jeni gjithmonë të organizuar dhe autoritar, por duhet të ndani përgjegjësitë edhe tek bashkëpunëtorët tuaj.

**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Do të riktheheni të jeni pozitiv dhe të gjallë dhe humor i mirë do të përdoret edhe për bashkëpunëtorët tuaj. Motivoni më mirë kolegët tuaj, në mënyrë që të krijoni një klimë më harmonike dhe të sheshoni mosmarrëveshjet e fundit. Në raport me partnerin/en, do të tregoheni më të kuptueshëm.

**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Kohëve të fundit keni qenë të mbushur me dyshime dhe kjo gjë edhe për shkak të disa konfirmimeve të cilat po vonojnë në vendin e punës. Mos jini shumë autokritik, pasi ndonjëse bëhet fjalë për një periudhë të lodhshme, do të arrini rezultate të rëndësishme.

**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Parashikohen ditë interesante për të rivlerësuar një raport, sidomos nëse gjatë muajve të fundit keni qenë mjaft konfuz nga pikëpamja sentimentale. Kjo e mërkurë do ju gjejë më të drejtpërdrejtë dhe skeptikë.

**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Parashikohet një ditë e rëndësishme për të reflektuar lidhur me disa çështje sentimentale, të cilat së fundmi të kanë hutuar nga qëllimet kryesore, shkruan noa.al.. Para se të merrni vendime lidhur me çështje ekonomike, bëni mirë që të ballafaqoheni me kolegët tuaj.

**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Kjo është një periudhë e cila ju sheh më të fortë, më aktiv dhe me më shumë ndikim në vendin e punës. Parashikohen objektiva të rëndësishme, por duhet të mbani parasysh vonesat të vogla të cilat mund t'iu bllokojnë.

**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Parashikohen mundësi shumë të mira për të rrezgjuar ndjenjat dhe pasionin, pas muajsh të tërë në gjendje jo shumë të mirë emocionale. Këshillohet që të jeni më romantik. Në sferën profesionale parashikohen të reja të rëndësishme. Bashkëpunimet dhe biznesi janë të favorizuara gjatë gjithë muajit.

NE KETE DATE

Mensur Mamuti	SHTETET NË FOTO, TË CILËT U PAVARËSUAN NGA BASHKIMI SOVJETIK ME 05.09.1991	SHTRESË	NDËRHYRJE KIRURGJIKE	I SËMURË NGA PARANOJA
BASTUN				
MBYLLËSE PËR SHISHE (SHQ.)				
AJRI I PASTËR MBI RETE				
TAUTOLOGJIA		RADIUMI		
AUTORI BULLGAR, PELIN				
ATDHETARI STRUGAN, IBRAHIM				
MANASTIRI			JODI	
VRASËSI I AINIT (KABIL)			SHKRONJË ARABE	

KOHA	ISH AVI NGA SHKUPI	URUGUAJI	ISH KRYEMINISTRI ITALIAN, BENEDETTO CRAXI	KOHA	GRUP MUZIKOR BRAZILIAN (LAMBADA)	KRAHINA SOCIA-LISTE AUTONOME
GYP				FSHAT NË TETOVË		
ENERGJIA		NGACMIN, NDEZJE SEKSUALE		LIBRI I SHENJËTË I MUSLIMANEVE		AUTORI YNE, FATMIR
3		ME SHKRONJA SHUMË TË VOGLA				GJ. E METË, MUNGESE
PRIËS I EMIRATEVE				SHKO QARQET E INETGRUARA		KALCIUMI DERR
I SJELL KËNAQËSI, E ARGËTOJ					ZJARRIMA (SH.)	
1					ANGSTREMI	
E						ZËDHËNËSJA E PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË, ZHUPA

ZGJIDHJET: SHKOP, TAPA, ETER, T RA, ELIN, TEMO, BT, J, KAOMA, TUB, KALLNIK, E, EKSITIM, LITUANIA, GJ, EMIR, IK, CA, KËNAQ, FTHET, ESTONIA, INA.

## Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

	7										4			6	9		1		
	5	8	7	9						3	6	1				5			7
	6	2	3	5			7												
	1	4		8	7	2	3				2		7		6			3	
	6	2				5	8			7									1
	5	8	4	2		7	1					3	8		1	2			
	8		7	5	4	3													
			3	1	8	6				2	4				8	1			9
						1					1		2	5					6

Shumë i lehtë: 837641925, 125879463, 496235871, 914587236, 762193584, 358426719, 681754392, 249318657, 573962148, Mesatar: 547369812, 396182547, 182475693, 821746935, 769523481, 453891276, 635914728, 274638159, 918257364.

# BARKË ME SHISHE PLASTIKE PËR TË SIGURUAR JETESËN



Muadh Abu Zayd, 35 vjeçar nga qyteti Rafah në jug të Rripit të Gazës, ka mbledhur mbi 700 shishe të hedhura të plastikës për t'i lidhur dhe bërë një barkë të cilën do ta përdorë për të zënë peshq

Një palestinez në Rripin e Gazës, rajon i përfshirë nga varfëria dhe papunësia për shkak të bllokadës së Izraelit, ka ndërtuar një barkë prej shisheve të mbetura të plastikës në mënyrë që të sigurojë jetesën e familjes së tij duke gjuajtur peshq, raporton Anadolu Agency (AA). Muadh Abu Zayd, 35 vjeçar nga qyteti Rafah në jug të Rripit të Gazës, ka mbledhur mbi 700 shishe të hedhura të plastikës për t'i lidhur dhe bërë

një barkë të cilën do ta përdorë për të zënë peshq. Abu Zayd, baba i katër fëmijëve, thotë se motivi që e ka shtyrë drejt kësaj ideje ka qenë mungesa e alternativave në rajon, ku varfëria arrin shkallë shumë të larta. Këtë ide e ka parë në rrjetin e videove Youtube, duke bërë disa shfaqje.

Ai tregon se ka përvajë 11-vjeçare si peshkatar, ndërsa thotë se njerëzit kanë mbetur të habitur kur për herë të

parë e ka lëshuar barkën në det. "Ata që më panë për herë të parë, menduan se si do t'u rezistojë valëve të forta me një barkë të thjeshtë. Megjithatë, përvojat e mia të suksesshme në lundrim në det i mënjantuan pikëpyetjet në kokat e njerëzve", shprehet peshkatori palestinez. Siç rrëfen ai, njerëzve u ka pëlqyer barka prej shisheve, ndërkohë që thotë se dëshiron ta zhvillojë dhe përmirësojë tutje atë në mënyrë që të shkojë në

vende edhe më të distancuara në det, pasi aktualisht lundron në distanca të shkurtra.

Sipas raportit të vitit 2017 të Byrosë Qendrore Palestineze të Statistikave, shkalla e papunësisë në Rripin e Gazës me afër dy milionë banorë arrijnë në 53 për qind. Ndërkaq, sipas të dhënave të vitit të kaluar të OKB-së, 80 për qind e popullatës në Gaza ka nevojë për ndihmë ndërkombëtare për të jetuar për shkak të varfërisë dhe papunësisë.




## Fisi do të vrasë djalin me 24 gishta, magjistari i tha se do pasurohen

Prindërit e një 12-vjeçari të lindur me 12 gishta të dorës dhe 12 të këmbës i kanë bërë thirrje policisë për të mbrojtur djalin nga sakrificimi i të afërmeve të tij lakmitarë. Sipas agjencisë aziatike ANI, djali i quajtur Shivanandan, nga fshati Gurri në rrethin e Barabankit të Uttar Pradesh, po përballë me kërcënime për jetën nga vetë familja e tij për shkak të "çrrëgullimit" në trup. Prindërit e tij u cituan duke thënë se të afërmit e tyre po kërkojnë t'i japin fund jetës së fëmijës pasi një magjistar u tha atyre se nëse sakrifikonin djalin do t'u garantohej një jetë plot me pasuri. "Ne e kemi ndaluar që të shkojë në shkollë. Ne gjithashtu kemi kërkuar ndihmë nga policia", tha babai i tij. Polici i rangut të lartë Umashankar Singh tha se policia kishte marrë një ankesë dhe se ai personalisht do ta hetonte çështjen. "Unë do të kryej një hetim të drejtë për çështjen dhe nuk do të lejoj që ai të qëndrojë i privuar nga arsimit. Ai është financiarisht i dobët, kështu që shpenzimet e tij arsimore do t'i paguaj unë", tha oficeri, sipas API. Lajmi nxiti protestë në mesin e publikut, me disa që kërkuar që magjistari i supozuar të dënohet.

## Ateistët më pak tolerantë se fetarët!

Një studim në 788 persona në Mbretërinë e Bashkuar, Francë dhe Spanjë arriti në përfundimin se ateistët mendojnë për veten e tyre si më të hapur sesa ata me besim, por janë në fakt më pak tolerantë ndaj mendimeve dhe ideve të ndryshme. Besimtarët fetarë "duket se i perceptojnë më mirë dhe i integrojnë perspektivat e ndryshme", sipas studiuesve të psikologjisë në Universitetin Katolik privat të Louvain (UCK), universitetit më të madh francez të gjuhës frënge të Belgjikës. Filip Uzareviç, i cili bashkë-shkroi këtë artikull, tha se mesazhi i tij ishte se "mendimi i mbyllur nuk gjendet domosdoshmërisht vetëm midis feve". Ai i tha PsyPost se "në studim, marrëdhënia midis fesë dhe mbyl-

ljes së mendimit varet nga aspekti specifik i mendjes së mbyllur". "Deri diku çuditërisht, kur erdhi në një prije të matur për të krahasuar pikëpamjes që ishin divergjente dhe në kundërshtim me perspektivat e veta, ishin fetë që treguan më shumë hapje", u shpreh Uzareviç. Dokumenti i dr.Uzareviç, i quajtur "Ateistët jo-demokratik?", thotë se mosbesimi është bërë normativ në disa vende perëndimore. Ai inspektoi 3 aspekte të ngurtësisë mendore në 445 ateistë dhe agnostikë, 255 të krishterë dhe një grup prej 37 budistësh, muslimanë dhe hebrenj. Studimi pohon se jo-besimtarët kanë më pak "dogmatizëm të vetë-raportuar", por ishin më të më lartë në "intolerancën e matur".



1522 - Magelani së bashku me Vitorinë kthehen në Spanjë pas lundrimit të parë nëpër botë.

1543 - Flota turko-frënge okupon Nicën.

1688 - Ushtria austriake okupon Beogradin.

1716 - Ndërtohet fanari i parë në SHBA (Boston).

1839 - Zjarr i madh kaplon Nju Jorkun.

1885 - Rumelia Lindore shpall bashkimin e saj me Bullgarinë. Kompletohet unifikimi i Bullgarisë.

1924 - Dështon tentimi për vrasje e Musolinit.

1939 - Sulmi i parë ajror gjerman ndaj Britanisë së Madhe në Luftën e Dytë Botërore.

1948 - Juliana shpallet mbretëreshë e Holandës.

1954 - Qëllohet një aeroplan amerikan mbi Siberi.

1968 - Svazilandi fiton pavarësinë nga Britania e Madhe (Dita kombëtare).

1991 - Bashkimi Sovjetik njeht pavarësinë e Estonisë.

1997 - Mbahet funerali i Princeshës Diana.

Sipas National Geographic çdo vit 18 miliardë paund (8 miliardë kilogramë) mbeturina plastike ndotin oqeanet në të gjithë botën. E gjithë plastika dëmton jetën detare. Breshkat po mbyten, ndërsa balenat dhe zogjtë detarë po ngordhin urie sepse barku i tyre është i mbushur me plastikë duke mos lënë hapësira për ushqim. Rreth 40% e plastikës në të gjithë botën vjen nga paketimi dhe 80% e plastikës së përdorur nuk është e riciklueshme.



### PROFESORI PYET BENIN

- Beni, çfarë të ndodh nëse të shkul një vesh?
- Do bëhem gjysëm shurdh profesor?
- Po nëse të shkul edhe veshin tjetër?
- Do ngelem qorr profesor... Profesori i trembur e pyet:
- E si ka mundësi që do ngelesh qorr?
- Po ngaqë s'kam ku ti var syzet profesor!



Fatkeqësisht politika dhe fatet e njerëzimit merren në dorë nga njerëzit mediokër dhe pa ideale. Njerëzit e mëdhenj, nuk i futen kurrë politikës. (Albert Camus)



KALENDARI HISTORIK 6 SHTATOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS